



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR HISTORINË
Material ndihmës për mësuesit e historisë në arsimin e mesëm të ulët



KLASAT 6-9

TIRANË, 2018

Përgatiti udhëzuesin:

Ines Todhe, IZHA

Kontribuoi:

Najada Hoxha, shkolla “Kushtrimi i lirisë”, Tiranë

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “Histori” në arsimin e mesëm të ulët është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

Prodhim i IZHA-s, 2018

www.izha.edu.al

Copy right © IZHA

TABELA E PËRMBAJTJES

1. QËLLIMI I UDHËZUESIT	3
1.1. Qëllimi	3
1.2. Përdoruesit e udhëzuesit	3
1.3. Struktura e udhëzuesit	3
2. RËNDËSIA E LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT	4
2.1. Synimet e mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e historisë	4
2.2 Risitë e lëndës së historisë	5
3. MODELE TË ZHVILLIMIT TË KOMPETENCAVE KYÇE NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS	6
4. INTEGRIMI NDËRLËNDOR	13
5. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS	16
6. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR	33
6.1 Llojet e planifikimeve	33
6.2 Planifikimi vjetor i lëndës	34
6.3. Planifikimi sipas periudhave	35
6.4 Planifikimi ditor	38
7. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E HISTORISË	41
7.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)	42
7.2. Vlerësimi i të nxënit (testi përmbledhës)	44
7.3 Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit	45
7.4 Vlerësimi periodik	49
7.5 Vlerësimi përfundimtar	49
7.6 Nivelet e arritjeve	50
7.7 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi	50
8. KRITERET E HARTIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË TESTIT	52
8.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi	53
8.2. Hartimi i testit	54
8.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste	56
8.4 Model testi	58
9. BIBIOLILOGRAFIA	72

1. QËLLIMI I UDHËZUESIT

1.1. Qëllimi

Udhëzuesi lëndor i lëndës së historisë për arsimin e mesëm të ulët trajton të gjitha aspektet e kurrikulës që nga planifikimi i kurrikulës, metoda të mësimdhënies, të nxënësve dhe nxënësve, vlerësimin e të nxënësve në kontekstin e zhvillimit të kompetencave gjatë zbatimit të programeve të historisë, klasa 6-9. Në këtë udhëzues janë kombinuar materiale për zbatim e kurrikulës me kompetenca nga eksperiencia dhe praktikat më të mira të mësuesve në shkollë.

1.2. Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret nga:

- mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve dhe rezultateve të nxënësve në lëndën e historisë.
- të gjitha institucionet arsimore në varësi të MASR-së, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë.
- institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e historisë, të cilët mund t'i referohen për formimin fillestar të mësuesve të rinj.

1.3. Struktura e udhëzuesit

Pjesë e udhëzuesit, përveç aspekteve të planifikimit të kurrikulës, teknikave të vlerësimit të realizimit të kompetencave, kritereve të hartimit dhe vlerësimit të testit, portofolit janë edhe modele/ shembuj¹:

- të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet kompetencave të lëndës;
- të integritimit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënësve;
- të përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive që përdoren për zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe kyçe;
- të planifikimit kurrikular të lëndës;
- të planifikimit të projektit kurrikular;
- të hartimit dhe vlerësimit të testit dhe portofolit.

¹ *Shënim: Shëmbujt/modelet e dhëna në udhëzues janë dhënë për qëllime ilustrimi dhe nuk janë ezaurues (shtrues).*

2. RËNDËSIA E LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj. Detyra e historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës.

2.1. Synimet e mësimdhënies dhe të nxënimit në lëndën e historisë

Historia i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë. Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t’iu përgjigjur zhvillimeve globale. Kurrikula e historisë në arsimin bazë pajis nxënësit me aftësi dhe cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Historia ndërton tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimit me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimin të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimin të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;

- argumentimit të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të medieve të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

2.2 Risitë e lëndës së historisë

Trajtimi i lëndës së historisë nëpërmjet koncepteve kyçe dhe kompetencave është risia kryesore e lëndës së historisë.

- Programet e historisë nëpërmjet të gjitha tematikave që zhvillon ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësorë që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe situatave të sugjeruara.

Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë janë:

Kompetenca historike:

1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Koncepte kyçe historike:

1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

- Në programet e historisë, për secilën klasë, janë menduar veprimtari, të cilat jepen në rubrikën “Situata të nxëni të sugjeruara”. Nëpërmjet këtyre veprimtarive hartuesi i tekstit dhe mësuesi integron historinë e shqiptarëve me historinë e qytetërimeve botërore si dhe lëndën e historisë me fushat e tjera kurrikulare dhe me temat ndërkurrikulare. Nxënësi, në orët e veprimtarive, zbaton në situata praktike kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe
- Në lëndën e historisë zënë vend temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet kësaj lënde është një komponent i rëndësishëm për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme.
- Po ashtu në programet e historisë janë dhënë Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

2.3.Shtrirja e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët

Lënda e historisë fillon në shkallën e dytë të kurrilës së arsimit bazë (AB), klasa e 4-t, duke vijuar deri në përfundim të AB shkalla e katërt e kurrikulës, klasa e 9-të.

- Në klasat 4, 5 dhe 6, lënda e historisë zhvillohet me një orë në javë;
- Në klasat 7-të; 8-të dhe 9-të, zhvillohet me dy orë në javë.

Tabela 1: Plani mësimor për lëndën e historisë në Arsimin Bazë

Klasa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Totali i orëve të historisë në AB
Plani mësimor Histori				1	1	1	2	2	2	315

Lënda e historisë në arsimin bazë, shkalla e dytë, e tretë dhe e katërt e kurrikulës, klasa 4-9-të, fillon me historinë personale, familjare, historinë lokale, për të vijuar në klasat më të larta (shkalla e tretë) të AB me historinë e qytetërimeve botërore dhe historinë e shqiptarëve, në periudhën parahistorisë, në periudhën antike, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohorë.

3. MODELE TË ZHVILLIMIT TË KOMPETENCAVE KYÇE NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS

Programi i historisë nëpërmjet temave, veprimtarive praktike, projekteve krijon kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit në arsimin bazë. Për të realizuar në praktikë lidhjen mes kompetencave të lëndës me kompetencat kyçe, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënësve, veprimtaritë dhe metoda/teknika që bëjnë të mundur realizimin e tyre. Kompetenca përcaktohet si demonstrim i njohurive, qëndrimeve dhe vlerave që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Më poshtë jepen disa shembuj/modele që bazohen në tema konkrete ku evidentohen rrugë dhe metoda për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve për realizimin e kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës së historisë. Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet zhvillimit të kompetencave historike dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

Shembull 1.

Nr.	Klasa	Tema	Metodologjia	Mjete ndihmëse
	6	Llogaritja e kohës	Diskutim /Lexim i orientuar/ Punë në grupe.	Teksti, fotografi të ndryshme, fletë A ₄ , stilolaps, laps

Mësuesi/ja, një orë para zhvillimit të temës u ka kërkuar të sjellin fotografi të tyre të bëra në vite të ndryshme, i orienton ata që të shohin fotot dhe të bëjnë një përshkrim të ndryshimeve që kanë ndodhur nga lindja e tyre deri më sot.

Kompetencat kyçe

- Kompetenca e të menduarit (përzgjedh fotot që pasqyrojnë ndryshimin dhe e ndihmojnë për të treguar të shkuarën e tij).
- Kompetenca e të nxënës

Kompetencat e lëndës

- Kërkimi, përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik (nxënësit prezantojnë ndryshimet duke iu referuar fotografive të tyre)
- Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën (nxënësit prezantojnë ndryshimet që kanë

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Në cilin vit keni lindur?
- Sa vite kanë kaluar nga viti i lindjes tuaj?

Kompetencat kyçe

- Kompetenca e të menduarit

Konceptet kyçe

- Koha dhe kronologjia

Mësuesi/ja ndërton në tabelë shiritin e kohës të cilin e ndan në dy pjesë, shënon dy periudhat historike para dhe pas Lindjes së Krishtit dhe kërkon nga nxënësit ta ndërtojnë atë në fletore dhe të shënojnë në të vitet e lindjes të pjesëtarëve të familjes së tyre dhe të tregojnë pse i kanë vendosur në mënyrë të tillë.

Kompetencat kyçe

- Kompetenca e të menduarit. (Nxënësit ndërtojnë shiritin e kohës)
- Kompetenca e të nxënës (Vendosin në të vitet e lindjes së pjesëtarëve të familjes

Kompetencat e lëndës

- Interpretimi historik (shënon në fletore dy periudhat historike para dhe pas Lindjes së Krishtit)

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Sa vite ka një shekull para dhe pas lindjes së Krishtit?
- Kur ka filluar dhe kur ka mbaruar shek. I p.K?
- Sa vite ka një mijëvjeçar?
- Në cilin mijëvjeçar përfshihet viti 2018?
- Ju keni lindur në vitin 2004, në cilin shekull dhe mijëvjeçar bën pjesë ky vit?
- Kur ka filluar shek XXI?
- Cili do të jetë viti I fundit i shek XXI?
- Cilit shekull i përket ngjarja “Kuvendi i Lezhës u mbajt më 2 mars 1444”?

Kompetencat kyçe

Kompetenca e të menduarit. *(Nxënësit kryejnë veprime matematikore për të llogaritur kohën në histori).*

Kompetencat e lëndës

- Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën. *(Nxënësit tregojnë ngjarjen historike duke e vendosur atë në kohë)*

Mësuesi/ja shënon në tabelë data të ngjarjeve të ndryshme historike si p.sh: Lufta e dytë iliro-romake ndodhi në vitin 229 para lindjes së Krishtit, Lojërat e para olimpike u zhvilluan në vitin 776 para lindjes së Krishtit, Skënderbeu lindi në vitin 1405, Kruja u rrethua për herë të parë në vitin 1450, dhe i fton t'i vendosin në shkallën e kohës duke pasur parasysh periudhat para dhe pas lindjes së Krishtit dhe të tregojnë arsyet përse i kanë vendosur në mënyrë të tillë.

Kompetencat kyçe

- Kompetenca e të menduarit, të nxënësve dhe komunikimit. *(Nxënësit kryen llogaritje, analizojnë të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën dhe shpjeguar atë).*

Kompetencat e lëndës

- “Interpretimi historik” dhe “Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën”. *(Nxënësit vendosin vitet në shkallën e kohës dhe argumentojnë pse para lindjes së krishtit vitet vijnë duke zbritur ndërsa pas lindjes së Krishtit*

Kompetencat konsiderohen të realizuara nëse nxënësi/ja:

- përdor numrat negative dhe pozitiv;
- kryen llogaritje për të përcaktuar shekujt, mijëvjeçarët para dhe pas Lindjes Krishtit;
- analizojnë të dhënat numerike për të kuptuar, shpjeguar dhe komunikuar të shkuarën;
- përcakton në cilin shekull apo mijëvjeçar bëjnë pjesë ngjarje të ndryshme historike;
- bën dallimin midis viteve, shekujve dhe mijëvjeçarëve para dhe pas Lindjes së Krishtit;
- vendos saktë në shkallën e kohës vitet, shekujt dhe mijëvjeçarët.

Shembull 2.

Nr.	Klasa	Tematika	Tema	Situata e të nxënësve	Metodologjia	Mjete ndihmëse
1.	7	Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	Kultura parakolumbiane e Amerikës	Mësuesi/ja shënon në tabelë emërtimet Astekë, Maja dhe Inkas dhe i kërkon nxënësve të tregojnë çfarë dinë rreth tyre dhe përgjigjet e	Paraqitje grafike e informacionit/ Punë në grupe/ Diskutim	Teksti, Hartë historike, enciklopedi, kompjuter i lidhur me internetin, materiale të ndryshme nga interneti.

				sakta i shënon në tabelë.		
--	--	--	--	---------------------------	--	--


Kompetencat kyçe

- Kompetencë e të nxënit
- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
- Kompetenca qytetare

Kompetencat e lëndës

- Kërkimi historik
- Përdorimi i burimeve

Hapi i parë. Mësuesi/ja shënon në tabelë emërtimet Astekë, Maja dhe Inkas dhe u kërkon nxënësve të tregojnë çfarë dinë rreth tyre dhe përgjigjet e sakta i shënon në tabelë. *(kompetencë e të nxënit)*



Mësuesi/ja ndan nxënësit në tre grupe dhe i jep detyrë secilit grup të kërkojë në internet dhe në Enciklopedinë e Historisë së Botës, për qytetërimet Maja, Asteke dhe Inkase.

- Grupi I. Gjeni informacion për shtrirjen e fiseve Asteke, organizimin e tyre ekonomik, politik e shoqëror dhe arritjet e tyre në shkencë art e kulturë.
- Grupi II. Gjeni informacion për shtrirjen e fiseve Maja, organizimin e tyre ekonomik, politik e shoqëror dhe arritjet e tyre në shkencë art e kulturë.
- Grupi III. Gjeni informacion për shtrirjen e fiseve Inkase, organizimin e tyre ekonomik, politik e shoqëror dhe arritjet e tyre në shkencë art e kulturë.

Nxënësit kërkojnë në internet dhe në Enciklopedinë e Historisë së Botës dhe mbledhin informacione e duhur për detyrën e ngarkuar. ***Në këtë rast përmbushet kompetenca e lëndës - përdorimi i burimeve (aksesojnë dhe shfrytëzojnë burimet për të marrë informacion) dhe kompetencat kyçe - kompetenca personale dhe kompetenca e të nxënësit (punojnë individualisht dhe në grup për të kërkuar, për të gjetur informacionin e kërkuar)***

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit (të ndarë në grupe) të përzgjedhin informacionet dhe fotot e të përgatisin një material për prezantim me një nga format (muzeu virtual, dokumentar, power point).

Çdo prezantim duhet të ketë në përmbajtjen e tij elementet si: pyetje, analizë të fakteve dhe argumenteve, konceptet historike dhe vlera e rëndësia e qytetërimit parakolumbian në të shkruarën dhe sot. ***(Në këtë rast përmbushet kompetenca e lëndës - kërkimi historik, kompetencat kyçe- kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetencë digjitale)***

Grupet prezantojnë punën e bërë me një nga format e kërkuara. Pas prezantimit nxënësit diskutojnë rreth saktësisë së informacionit dhe e plotësojnë atë. ***Në këtë rast përmbushet kompetenca e lëndës- kërkimi historik dhe përdorimi i burimeve dhe kompetencat kyçe - kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (grupet komunikojnë informacionin e përgatitur për qytetërimet Actekë, Maja dhe Inkas, konceptet qytetërim, qytetërim parakolumbian, tempuj piramidë etj). Kompetencë personale (komunikon vlerësimin që ka për qytetërimet parakolumbiane, rëndësinë që ka sot kjo kulturë si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe atraksion turistik).***

Kompetencat konsiderohen të realizuara nëse nxënësi/ja:

- Vendos në kohë periudhën e fillimit dhe përfundimit të qytetërimeve Asteke, Maja dhe Inkase;
- Tregon në hartë shtrirjen e këtyre qytetërimeve;
- Evidenton vecoritë e organizimit shtetëror, ekonomik, shoqëror në këto vende;
- Përshkruan elementet e përbashkëta të jetës ekonomike të tri qytetërimeve;
- Vlerëson arritjet e këtyre qytetërimeve në shkencë, art e kulturë.

Shembull 3.

Nr.	Klasa	Tematika	Tema	Situata e të nxënësit	Metodologjia	Mjete ndihmëse
1.	9	Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare	Qytetërimi ilir	Nxënësit prezantojnë gjetjet për shtrirjen e fiseve ilire, origjinën e tyre, për besimin dhe elementet e artit e kulturës ilire,	Diskutim/ Ditari dy pjesësh/ Leximi i orientuar	Teksti, Hartë e shtrirjes së fiseve ilirë, Fjalori Enciklopedik Shqiptar vol I, materiale nga internet.

				foto të objekteve apo zonave arkeologjike.		
--	--	--	--	--	--	--

Kompetencat kyçe

- Kompetenca qytetare
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Kompetencat e lëndës

- Kërkimi historik
- Përdorimi i burimeve
- Analiza shkak-pasojë

Punë përgatitore Një orë para zhvillimit të temës mësuesi/ja i kërkon nxënësve që të kërkojnë në internet apo në tekste informacion për shtrirjen e fiseve ilire, origjinën e tyre, për besimin dhe elementet e artit e kulturës ilire, foto të objekteve apo zonave arkeologjike.

Nxënësit prezantojnë gjetjet. Në kryerjen e kësaj punë përgatitore, mësuesi synon të realizojë **kompetencën e lëndës - përdorimi i burimeve** (*aksesojnë dhe shfrytëzojnë burime të ndryshme për të përgatitur informacionin*) dhe **kompetencën kyçe - kompetenca e sipërmarrjes, jetën dhe mjedisin** (*nxënësi kërkon dhe përzgjedh informacion për temën individualisht*). **Kompetencën personale** - (*nxënësi shqyrton një sërë burimesh që paraqesin tezat pro dhe kundër origjinës autoktone të ilirëve*)

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të lexojnë çështjen “Origjina ilirëve” dhe të punojnë në dyshe ku një nga nxënësit ngre çështje dhe tjetri bën komentet për të.

- Mësuesi/ja ndërton në tabelë ditarin dypjesësh.
- Nxënësit protësojnë pjesët e ditarit dhe i prezantojnë ato.

Çështja	Komenti
Origjina ilire	<p>→ Teza 1: ilirët janë një popull autokton, që u formuan si popull në territorin perëndimor të Ballkanit, gjatë fundit të mijëvjeçarit II pr.K. (periudha e bronzit) dhe mijëvjeçarit I pr.K. (periudha e hekurit); kishin gjuhën, kulturën e tiparet e përbashkëta.</p> <p>→ Teza 2: ilirët janë të ardhur që u përzien me popullsinë vendase.</p>

Nxënësit të mbështesin njëri-njëri nga tezat dhe argumentojnë qëndrimin e tyre.

Kompetencë e lëndës - interpretimi historik (Nxënësit prezantojnë dy qëndrimet për origjinën e ilirëve dhe mbrojnë tezën e parë duke u mbështetur në zbulimet arkeologjike dhe studimet gjuhësore (fjalë nga pellazgjishtja që gjejnë kuptimin e tyre në gjuhën e ilirëve).

Kompetencë kyçe - kompetencë qytetare (Nxënësit shpjegojnë origjinën duke vlerësuar zbulimet arkeologjike dhe gjuhësore) dhe **kompetencë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** (Nxënësi vlerëson burimet, zbulimet arkeologjike dhe gjuhësore, në shfaqjen e qëndrimit të tij).

Hapi III. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë çështjen “Vendndodhja e ilirëve” dhe më pas kërkon nga ata të tregojnë në hartë kufijtë e Ilirisë, shtrirjen e fiseve si: liburnët, dalmatët, ardianët, dardanët, pajonët, taulantët, enkelejtët, desaretët, molosët, kaonët dhe tesprotët; mesapët, japigët; të tregojnë shtrirjen e mbretërisë Dardane dhe shtetit të Epirit. **(kompetenca kyçe - kompetencë e të nxënësit)**

Hapi IV. Mësuesi/ja ndërton në tabelë ditarin dypjesësh dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në tekst çështjen “Organizimi ekonomik-shoqëror i ilirëve” dhe përsëri në dyshe të plotësojnë ditarin dypjesësh duke analizuar zhvillimin ekonomik dhe evidentuar ndryshimet që solli zhvillimi ekonomik te ilirët.

Çështja	Komenti
Ndryshimet që solli zhvillimi ekonomik te ilirët	<p>→ Në ekonomi – u zhvilluan degë të tilla si: bujqësia, blegtoria, gjuetia, peshkimi, kriporja, rritja e bletës, poçaria, metalurgjia, tregtia dhe këmbimi; prenë monedhat e tyre prej bronzi e argjendi;</p> <p><i>Ndryshimet në ekonomi sollën</i></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 45%;"> <p>Ndërtimin e qyteteve bashkëkohore</p> </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: 45%;"> <p>U kalua në shoqërinë me shtresa. U formuan shtetet e para Lindi shoqëria skllavopronare ilire.</p> </div> </div>

Kompetencat që realizohen: Kompetenca e lëndës – analiza shkak-pasojë (Zhvillimi ekonomik solli si pasojë ngritjen e qyteteve bashkëkohore, kalimin nga shoqëria fisnore në shoqërinë me shtresa dhe formimin e shteteve) dhe **kompetencës kyçe - kompetenca e jetës, sipërmarrjes dhe mjedisit** (Bashkëvepron në dyshe për të analizuar zhvillimin ekonomik dhe evidentuar ndryshimet në shoqërinë ilire).

Kompetencat konsiderohen të realizuara nëse nxënësi/ja:

- parashtron teza kryesore për origjinën e ilirëve dhe paraqet argument për tezën që mbon;
- tregon në hartë shtrirjen e ilirëve, fiseve dhe qyteteve ilire dhe ndarjet fiziko – gjeografike;

- evidenton kur dhe ku u krijua shteti i parë ilir;
- përcakton tiparet e zhvillimit ekonomik e shoqëror e kulturor të ilirëve.

4. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Integrimi ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënimit mundëson lidhjen e historisë me lëndët brenda fushës dhe me fushat e tjera kurrikulare, në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të ulët të shihet si një e tërë për formimin e nxënësit dhe për realizimin e qëllimeve kryesore të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Në lëndën e historisë temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të bëjnë lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Shembull 1.

Integrimit ndërlëndor brenda fushës së të nxënimit

Përshkrim i shkurtër: Tema mësimore “Përmbysja e regjimit carist në Rusi. Vendosija e plotë e regjimit totalitar komunist” trajton përmbysjen e regjimit carist në Rusi me anë të revolucionit demokratik të tetorit të 1917 dhe vendosjen e Republikës, ardhjen e komunistëve në pushtet dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit. Në këtë temë përfshihen njohuri që kanë të bëjnë me pozitën gjeografike të Rusisë dhe tri Republikave që u bë në pjesë të BS, tiparet e zhvillimit ekonomik të Rusisë komuniste, liritë dhe të drejtat e individit në shtetin diktatorial.

Skema e integrimit

Klasa	Histori	Gjeografi	Qytetari
8	Përmbysja e regjimit carist në Rusi. Vendosija e plotë e regjimit totalitar komunist	Rajoni i Evropës Lindore	Kuptimi për të Drejtat dhe Liritë të Njeriut
	<p>Arsyet që sollën vendosjen e diktaturës së proletariatit në Rusi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e Rusisë në Luftë; - Mungesa e ushqimeve dhe rritja e çmimeve - Ushtria ruse kishte pësuar humbje të 	<p>Ndikimi i pozitës gjeografike të Rusisë Tanskaukazisë,</p> <p>Ukrahinës dhe Bjellorusisë në krijimin e BS.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike e Rusisë - Pozita 	<p>Ndikimi i diktaturës së proletariatit në të liritë dhe të drejtat e individit në BS</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimimi i të drejtave dhe lirive; - Liritë dhe të drejtat vetjake; - Liritë dhe të drejtat politike dhe qytetare - Liritë dhe të drejtat

	mëdha - Të vendosur përballë vështirësive ushtarët rus dezertonin Revolucioni i tetorit 1917;	gjeografike e Tanskaukazisë, Ukrainës dhe Bjellorusisë; - Zhvillimi ekonomik i BS- së;	ekonomike, sociale e kulturore;
--	--	--	------------------------------------

Shembull 2.

Përshkrim i shkurtër: Tema mësimore “Shqipëria në rrugën e integrimit euroatlantik në vitet 1991-2013” trajton përpjekjet e Shqipërisë për t’u integruar në strukturat euroatlantike, veçanërisht hapat e ndjekur nga shteti Shqiptar dhe BE-ja për integrimin e vendit në Bashkimin Europian si vendosja e marrëdhënieve diplomatike me BE-në, nënshkrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Marrëveshja e Lehtësimit të Lëshimit të Vizave, kërkesa për anëtarësim në BE. Në këtë temë përfshihen njohuri që kanë të bëjnë me arsyet pse vendi ynë aspiron të bëhet pjesë e BE-së, rëndësia dhe prespektiva e zgjerimit me vendet e Ballkanit.

Skema e integrimit

Klasa	Histori	Gjeografi
9	Shqipëria në rrugën e integrimit euroatlantik në vitet 1991-2013	Roli i BE-së dhe perspektiva e zgjerimit
	Rruga e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian - Përpjekjet e shtetit shqiptar për t’u integruar në strukturat euroatlantike në vitet 1991-1996 - Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me BE; - Hapja e negociatave të Shqipërisë me BE-në - Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit - Marrëveshja për Lehtësimin e Lëshimit të Vizave Kërkesa për Anëtarësim në BE	Roli i BE dhe perspektiva e zgjerimit - Përbërja e BE-së; - Vendet e Ballkanit që aspirojnë të anëtarësohen në BE; - Roli i BE-së; - Shqipëria vend kandidat për anëtarësim në BE - Rëndësia e anëtarësimit në BE

Shembull 3.

Përshkrim i shkurtër: Tema “Ndarja dhe llogaritja e kohës në Histori” trajton ndarjen e kohës në histori, ndarjen në dy periudha para dhe pas lindjes së Krishtit, ndarjen në shekuj dhe mijëvjeçarë . Në këtë temë përdoren numrat negativë dhe pozitivë për llogaritjen e kohës dhe vendosjen e tyre në shiritin e kohës (bosht).

Skema e integritit

Klasa	Histori	Matematikë
6	Ndarja dhe llogaritja e kohës në Histori	Tematika –Numri, Algjebra dhe funksioni
	Si ndahet koha në histori <ul style="list-style-type: none"> - Dy periudhat historike (para dhe pas lindjes së Krishtit); - Shekuj dhe mijëvjeçarë para dhe pas lindjes së Krishtit; - Ndryshimet mes tyre; 	Llogaritja e kohës në histori <ul style="list-style-type: none"> - Llogaritja e kohës me numrat negativë dhe pozitivë - Mbledhja dhe zbritja me numra dy e tre shifror për llogaritjen e shekujve dhe mijëvjeçarëve; - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave për llogaritjen e shekujve dhe mijëvjeçarëve; Vendosja e viteve, shekujve dhe mijëvjeçarëve para dhe pas lindjes së Krishtit në shkallën e kohës (bosht).

Shembull 4. Integrimi shumëdisiplinar

Përshkrim i shkurtër: Tema “Rilindja” trajton kushtet historike të lindjes së Rilindjes, arsyet pse lindi në Itali si: zhvillimi i qyteteve, pozita favorizuese e Italisë për zhvillimin e tregëtisë me kontinentet e tjera, faktorët që ndikuan në përhapjen e saj në Evropë, ndryshimet që solli në ekonomi, shkencë e arte.

Skema e integritit

Klasa	Histori	Gjeografi	Gjuhë shqipe	Fizikë
7	Rilindja	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve. - Evropa. - Proceset natyrore dhe shoqërore. 	Tragjedia–Hamleti (Shekspir)	Forca e rëndesës dhe pesha

Histori	Gjeografi	Arte	Letersi	Shkenca
<ul style="list-style-type: none"> - Ndikimi i Humanizmit në lindjen e Rilindjes - Përhapja e ideve të Humanizmit; - Zhvillimi ekonomik shkencor; - Ndryshimet 	<ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike e Italisë; - Italia si pjesë e rëndësishme e rrugëve tregtare Evropë–Azi–Afrikë; 	<ul style="list-style-type: none"> - Në arte ndryshuan subjektet dhe simbolika e veprave; - Veprat e Leonardo Davincit, Mikelanxhelo Buanaroti.etj., pjesë 	<ul style="list-style-type: none"> - Në veprat letrare pasqyrohen shpirti njerëzor, pushteti, dashuria, marrëdhëniet njerëzore. - Pasuria e veprave të 	<ul style="list-style-type: none"> - Teoria e Helicentrizmit - Galileo Galilei, fizikan, matematicien,

<p>në mënyrën e jetesës dhe edukimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Atdheu i Rilindjes - Qytetet më të zhvilluara në Itali; - Vecoritë e Rilindjes <p><i>(Sollli zhvillim në letërsi, arte, shkencë, ekonomi, politikë dhe jetën shoqërore; Përhapet në Evropë; Lëvizja e lirë brenda monarkive të kohës;)</i></p>		<p>përbërëse e trashëgimisë kulturore;</p>	<p>Shekspirit dhe e autorëve të tjerë të Rilindjes</p>	
--	--	--	--	--

5. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Përdorimi i metodologjive të larmishme dhe efikase në mësimdhënien e historisë është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësit, duke i dhënë secilit mundësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Përdorimi i një numri të larmishëm metodash/teknikash në mësimin e historisë nga mësuesit është një element thelbësor në procesin e zbatimit të kurrikulës së historisë, në arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënësit, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe të të nxënësit dhe kompetencave e koncepteve historike, në lidhjen e historisë me lëndët dhe fushat e tjera të të nxënësit, në integrimin e temave ndërkurrikulare, si dhe në zotërimin e cilësive historike për përmbushjen me sukses të qëllimeve arsimore. Të nxënësit në lëndën e historisë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënësit, në mënyrë që ata të kuptojnë, të përbrendësojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen. Edhe pse të nxënësit në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mësimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës. Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxënësit. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënësit e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxënësit gjatë gjithë jetës. Ato zgjidhen në përshtatje me

përmbajtjen lëndore, me nivelin e nxënësve, me veçoritë e temave të ndryshme mësimore dhe në varësi të gjendjes së materialeve burimore dhe didaktike.

Shembull 1.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Anglia në përfundim të revolucionit	- Puna me fakte; - Diagrami i Venit


Puna me faktet

Mësuesi/ja ui shpërndan nxënësve përmbajtjen e “Aktit mbi të drejtat e Njeriut” në format A4 dhe i orienton ata të nënvizojnë të drejtat dhe kufizimet që i përkasin mbretit dhe parlamentit. Pas përfundimit të punës nga nxënësit mësuesi/ja shtron pyetjet:

1. Cfarë pushteti ushtronte mbreti?
2. Ku konsiston fuqia e parlamentit?
3. Pse parlamenti ka pushtet më të madh se mbreti?
4. A ndikoi akti për ndrysimin e formës së qeverisjes në Angli?

Diagrami i Venit

Mësuesi/ja iu shpërndan nxënësve një fletë formati ku janë shkruar disa nga të drejtat politike që gëzon qytetari sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe i orienton ata që të gjejnë të përbashkëtat dhe dallimet mes të drejtave politike që gëzonte qytetari nëpërmjet Aktit mbi të Drejtat e Njeriut dhe ato që gëzon nëpërmjet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe kërkon që këtë ta paraqesin me anë të diagramit të Venit.



Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- përcakton raportin mes mbretit e Parlamentit sipas Aktit mbi të Drejtat e Njeriut;
- evidenton ndikimin e Aktit mbi të Drejtat e Njeriut për organizimin shtetëror në Angli;
- tregon të drejta civile që fitoi qytetari anglez dhe bën dallimin midis të drejtave që qytetarët fituan nga Akti mbi të Drejtat e Njeriut dhe të drejtave që gëzojnë qytetarët nëpërmjet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Shembull 2.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Momentet kryesore gjatë Luftës së Ftohtë	<ul style="list-style-type: none">- Stuhi mendimi;- Lexim i drejtuar;- Ditaret e të nxënit

Stuhi mendimi

Mësuesi/ja i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Luftën e ftohtë:

- Pse lufta mes dy blloqeve u quajt “Luftë e ftohtë”?
- Analizoni fjalinë “SHBA-ja dhe BS-ja vendosnin fatin e botës”
- Cilat ishin përpjekjet e dy superfuqive për të rritur ndikimin e tyre në Evropë dhe botë?
- Përshkruaj tiparet e Luftës së ftohtë?

Lexim i drejtuar/ pyetje-përgjigje

Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet. Mësuesi/ja i kërkon që nxënësit të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje dy pjesët e para të temës: “Ashpërsime dhe vetëpërmbytje” dhe “Ballafaqime në distancë” dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:

- Pse dy superfuqitë shpenzonin për armatime?
- Pse nuk u zhvillua një luftë të armatosur mes tyre?
- Cilat janë veçoritë e konkurrencës në planin ushtarak?
- Cilat janë veçoritë e konkurrencës në planin politik dhe ekonomik?

Lexim i drejtuar/ pyetje -përgjigje

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje pjesën e tretë të temës: “Përballja e forcave të të dy blloqeve” dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:

- Cilat ishin konfrontimet më të ashpra mes dy blloqeve?
- Cilat ishin tiparet e “krizës greke”? - Kur përfundoi ajo?
- Pse u shkaktua kriza e Berlinit”? - Pse bllokada ekonomike e Berlinit nuk ia arriti qëllimit?
- Në cilën nga “krizat” arriti kulmin konfrontimi i dy superfuqive?
- Cilat janë pasojat e konfrontimeve?
- Rendisni sipas kronologjisë ngjarjet si: Kriza greke, Kriza e Berlinit, Kriza koreane, Kriza e Vietnamit dhe e Kubës.

Mësuesi/ja vepron në të njëjtën mënyrë, pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet dhe më pas i kërkon që nxënësit të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.

Ditaret e të nxënit

Mësuesi fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes. Në një rën anë ata mund të shkruajnë ngjarjet (krizat) dhe në anën tjetër të shkruajnë një koment për të. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:


- identifikon mënyrat e përbaljes të dy blloqeve;
- analizon krizat gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë;
- rendit në radhë kronologjike krizat mes dy blloqeve;
- shfaq qëndrimin e tij për Luftën e Ftohtë.

Shembull 3.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Zhvillimet politike në Shqipëri në vitet 1921-1924	<ul style="list-style-type: none"> - Përvijim i të menduarit; - Shënime mbi shënime - Diskutim

Përvijim i të menduarit

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të lexojnë për disa minuta pjesën “Fillesat e parlamentarizmit në Shqipëri. Grupimet politike në vitet 1921-1924” dhe i fton ata në diskutim ndërkohë që ka ndërtuar në tabelë skemën e përvijimit të të menduarit.



Shënime mbi shënime

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të ndarë në grupe të lexojnë për pak minuta. Pas leximit mësuesi/ja i udhëzon të plotësojnë skemën.

Idetë ose kategoritë kryesore i vendos treguesin 1 në radhitje, ndërsa detajeve i vendos treguesit 2, 3.

Treguesi	Zhvillimet në politikën e jashtme dhe të brendshme në Shqipërinë e viteve 1921-1924
1	Rinjohja e pavarësisë së Shqipërisë
2	Qeveria e Tiranës kërkon anëtarësimin e saj në Lidhjen e Kombeve.
3	Mbështetje nga Britania e Madhe.
3	Shqipëria u pranua anëtare e Lidhjes së Kombeve.
3	Fuqitë e Mëdha njihnin pavarësinë e Shqipërisë dhe tërësinë e saj territoriale me disa rregullime në veri, në favor të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene.
3	U njoh qeveria shqiptare.
3	Shteti shqiptar vendos marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera.
2	Situata e rënduar ekonomike
3.	Mungesa e reformës agrare kishte krijuar pakënaqësi në radhët e fshatarësisë.
3.	Tregtarët e mesëm ishin të pakënaqur, pasi nuk merrnin nga shteti shërbimet e duhura

3.	Popullsia, kryesisht në Veri, ishte goditur nga uria.
3.	Buxheti i shtetit ndodhej në gjendje të mjerueshme.
3.	Usharakët dhe nëpunësit në muajt e parë të vitit 1924 nuk morën pagat e tyre.
2.	Mungesa e qëndrueshmërisë politike
3.	Lufta e ashpër për pushtet.
3.	Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924, kur opozita, e mbështetur edhe nga ushtria mori pushtetin.
3.	Në dhjetor 1924, A. Zogu filloi ndërhyrjen e armatosur kundër qeverisë së Nolit dhe ia doli të rimerrte pushtetin

Diskutim

Mësuesi/ja nxit diskutimin nëpërmjet pyetjeve:

- Cilat janë grupimet politike në vitet 1921-1924?
- Cilat ishin shtresat që përfaqësonin grupimet politike?
- Cili ishte qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj Shqipërisë?
- Kur u mbajt Konferenca e Ambasadorëve në Paris?
- Cilat ishin vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Paris?
- Pse shpërtheu Lëvizja e Qershorit të vitit 1924?

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- evidenton elementët e para të parlamentarizmit në Shqipëri duke listuar grupimet politike gjatë viteve 1921-1924;
- përshkruan vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe pasojat e tyre;
- shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit 1924;

Shembull 4.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Qëndresa shqiptare ndaj pushtimit italian 1939-1943	<ul style="list-style-type: none"> - Imagjinata e drejtuar - Të nxënësit e këmbime (punë me grupe) - Shkrimi i lirë

Imagjinata e drejtuar

- Mësuesi/ja prezanton foto të Shqipërisë në vitet 1939-1943 dhe iu kërkon nxënësve të përfytyrojnë Shqipërinë nën pushtimin Italian dhe të imagjinojnë jetesën që bënin bashkëmoshatarët e tyre. Çfarë do të bënit ju po të jetonit në këtë periudhë.
- Pas imagjinatës nxënësit diskutojnë me njëri tjetrin.
- Nxënësit prezantojnë përshkrimin.
- Diskutohen pyetjet që lindin gjatë prezantimeve.

Të nxënit me këmbime

Mësuesi/ja i vendos nxënësit në 4 grupe fillestare dhe i ndan pjesët e tekstit sipas numrave 1, 2, 3 dhe 4 dhe i udhëzon për pjesët që do të lexojnë.

Nxënësit me numrin 1 lexojnë pjesën: Qëndresa shqiptare gjatë viteve 1939-1941;

Nxënësit me numrin 2 lexojnë pjesën: Qëndresa e organizuar e shqiptarëve kundër pushtuesve italianë;

Nxënësit me numrin 3 lexojnë pjesën: Marrëdhëniet ndërmjet PKSH/FNÇ-së dhe Ballit Kombëtar;

Nxënësit me numrin 4 lexojnë pjesë nga Rezoluta e PKSH.

<p>Nxënësi 1 Eksperti 1 Cilat janë veçoritë e qëndresës së shqiptarëve ndaj pushtuesve italianë</p>	<p>Nxënësi 2. Eksperti 2 Cilat janë forcat politike që u angazhuan në luftë kundër pushtuesit dhe çfarë roli luajtën në luftë?</p>	<p>Nxënësi 3. Eksperti 3 Përshkruaj marrëdhëniet mes grupimeve/partive politike në vitet 1939-1943</p>	<p>Nxënësi 4. Eksperti 4 Krahasoni qëllimet, detyrat dhe veprimet e PKSH dhe Ballit Kombëtar</p>
---	--	--	--

Gjatë kësaj kohe mësuesi/ja ndan fletët e ekspertit me numrat për çdo nxënës në grup ku janë të shënuara edhe pyetjet ku do të përqëndrohet diskutimi në grup. Nxënësit lexojnë në grupet fillestare për disa minuta dhe pastaj bashkohen në grupe të tjera sipas numrave të përcaktuar. Në këto grupe diskutojnë dhe këmbëjnë mendime për pyetjet e shënuara, më pas kthehen në grupet fillestare ku prezantojnë mendimet e tyre të plotësuara dhe ekspertët shkruajnë përgjigjet përfundimtare.

- Secili ekspert jep përgjigje për pyetjen e caktuar sipas numrit.
- Diskutohen përgjigjet.

Shkrimi i lirë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të përzgjidhin një temat e mëposhtme dhe të shkruajnë një ese:

1. Përhëndetja e Frontit Nacionalçlirimtar “Vdekje fashizmit – Liri popullit”;
2. Përhëndetja e Ballit Kombëtar “Shqipëria Shqiptarëvet!”

Diskutohen në klasë kuptimi i këtyre parullave dhe qëllimet e këtyre organizatave:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:


- evidenton tiparet e qëndresës së hershme të shqiptarëve kundër pushtuesve italianë;
- përkufizon termat qëndresë, demonstratë, organizatë politike, Fronti Nacionalçlirimtar;
- përcakton tiparet e qëndresës së organizuar të shqiptarëve ndaj pushtimit italian;
- krahason qëllimet, detyrat dhe veprimet e PKSH dhe Ballit Kombëtar;
- evidenton grupimet kryesore politike jofashiste në Shqipëri;

Shembull 5.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Trashëgimia osmane në art, kulturë, ekonomi dhe jetën e përditshme	<ul style="list-style-type: none"> - Kllaster - Studimi kërkimor (punë në grupe)/ - Diskutim

Kllaster

Mësuesi/ja shënon në tabelë termin trashëgimi osmane dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë rreth objekteve apo elementeve të trashëgimisë osmane në jetën tonë të përditshme



Studimi kërkimor

Mësuesi/ja i vendos nxënësit në sallën e informatikës dhe i ndan ata në 4 grupe dhe çdo grupi i cakton detyrat:

Grupi 1. Kërkoni në internet informacion për ndikimin e qytetërimit osman në strukturën e qyteteve si Tirana, Shkupi, Gjakova, Sarajeva, Beogradi, Sofia në shek.XVII-XVIII.

Grupi 2. Kërkoni informacion dhe foto të veshjeve të grave dhe burrave të Tiranës, Shkupit, Beogradit, Bukureshtit, që tregojnë ndikimin e kulturës osmane.

Grupi 3. Kërkoni informacion dhe foto nga ceremonitë festive/ritet ku evidentohen elementet e kultures osmane.

Grupi 4. Kërkoni huazime të fjalëve osmane që përdoren edhe sot. *(Në rastet kur në shkollë nuk ka internet mësuesi i ndan çdo grupi foto për detyrat e dhëna).*

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të përgatisin prezantimet me informacionet e gjetura.

Diskutimi

Në fazën e fundit një përfaqësues për çdo grup prezanton punimin e grupit dhe më pas grupi 1 diskuton punim i paraqitur nga grupi 4, grupi 2 diskuton prezantimin e bërë nga grupi 3 dhe grupi 3 vlerëson punën e bërë nga grupi 1.

Mësuesi/ja ngre si çështje për diskutim:

- Pse ndikimi i qytetërimit osman ishte më i madh në vendet si Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia se në vendet si Serbia, Greqia e Rumania.
- Trashëgimia kulturore e qytetërimit osman a përbën vlerë në kulturën e vendeve të Ballkanit.

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- Identifikon elementet e qytetërimit osman në jetën e përditshme, artin, kulturën, besimin dhe ekonominë e vendeve të Ballkanit.
- Përshkruan ndikimin e këtij qytetërimi në vendin tonë dhe vende të tjera të Ballkanit.

- vlerëson trashëgiminë e qytetërimit osman në art, në kulturë, në shkencë, në ekonomi dhe në jetën e përditshme.

Shembull 6.

Tema mësimore	Metoda\ teknika
Opozitarët e regjimit komunist	<ul style="list-style-type: none"> - Lexim i orientuar (pyetje- përgjigje) - Minuta e debatit - Punë me faktet dhe përdorimi i burimeve/ muzeu virtual

Lexim i orientuar (pyetje- përgjigje)

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e dhënë në tekst dhe nxit diskutimin me anë të pyetjeve:

- Sa është numri i të burgosurve politikë sipas raportit të Institutit të Studimeve për Krimet e Komunizmit?
- Sa prej tyre ishin femra?
- Sa ishte numri i të dënuarve me vdekje?
- Sa prej tyre ishin femra?
- Pse u burgosën dhe u vranë kaq shumë njerëz?

Minuta e debatit

Mësuesi/ja shfaq me video-projektor pamje nga proceset gjyqësore dhe burgjet e kohës së diktaturës dhe kërkon prej tyre të debatojnë për të drejtat dhe lirive të qytetarit në një shtet diktatorial etj.

Punë me faktet dhe përdorimi i burimeve.

Mësuesi/ja orienton nxënësit të kërkojnë në internet dhe literaturën historike dhe të grumbullojnë informacione, foto, mbi vuajtjet e disa prej personazheve të dënuar apo ekzekutuar nga regjimi komunist për shkak të bindjeve të tyre politike apo besimit fetar (p.sh: Musine Kokalari, Gjergj Shefqet Beja, Selaudin Toto, Sabiha Kasimati, Osman Kazazi, Pjetër Arbnori, At Zef Pllumi, Haxhi Hafiz, Sabri Koci).

Muzeu virtual

- Mësuesi/ja orienton nxënësit që të organizojnë kronologjikisht ose tematikisht materialin e grumbulluar.
- Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të shënojnë diçiturat përkatëse në çdo foto si dhe të bëjnë një jetëshkrim të shkurtër të personazheve që paraqiten në të dhe këto ti prezantojnë me anë të muzeut virtual.

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- formon kujtesën historike, nëpërmjet fotografive të ndryshme;
- evidenton mungesën e të drejtave të njeriut;
- analizon marrëdhëniet e shtetit të diktaturës së proletariatit me qytetarët;

- mban qëndrim për dhunën e ushtruar nga regjimi komunist kundër kundërshtarëve të tij;

Shembull 7 “Të mësuarit me projekt”

Projekti kurrikular në lëndën e historisë është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.

Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimit dhe në qendër nxënës në përmes së cilës nxënës në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti, si veprimtari integruar me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK-ut, të sipërmarrjes etj.

Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja. Zbatimi i një projekti në lëndën e historisë kërkon më shumë se një orë mësimore.

Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është dicka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënës dhe përgjatë zhvillimit të tij. ***Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.***

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënës që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënës për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënës për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.

Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, interpretimi etj.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen burimet.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga burimet dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditë çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- *Tema e projektit* (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore* (Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- *Rezultatet e të nxënit* – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projektit).
- *Partnerët* (Nëse ka, p.sh. nëse projekti ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për historinë gojore një dëshmitar real mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt).
- *Veprimtaritë kryesore:* (përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit).
- *Burimet kryesore të informacionit* (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e historisë një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, hartave dhe teksteve të ndryshme si enciklopeditë, revistat, etj., janë arkivat, muzetë etj).
- *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh. nëse projekti planifikohet në 6 orë atëherë duhet vendosur tematika për të gjashta orët)
- *Përshkrimi i produktit të projektit* (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi* (Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënit.

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Shembull projekti – Periudha e parë

Tema e projektit: Qytetërimi ilir

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 3 orë

Klasat pjesëmarrëse: 6 A, B, C, D

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të projektit nxënësi:

- paraqet fakte historike lidhur me qytetërimi ilir;
- analizon tezat për origjinën e ilirëve;
- përkufizon konceptin etnos ilir;
- tregon rolin dhe rëndësinë e fiseve dhe qyteteve ilire;
- ndërthur informacionin teorik me atë që shohin në muze;
- vlerëson qytetërimin ilir si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të turizmit;
- përdor burime të larmishme dhe të testuara informacioni;
- përdor TIK-un për të prezantuar projektin.

- prezanton informacionin në një nga format si poster/ fletë palosje/ dokumentar/ power point;

Konceptet kryesore

Iliri, qytetërim ilir, etnos, iliri, fise ilire, qytete ilire, shteti ilir.

Partnerët që do marrin pjesë në projekt

Prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup.
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- Grumbullimi i informacionit.
- Përpunimi i të dhënave.
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithësecili nga nxënësit.

Personat përgjegjës për realizimin e projektit:

Mësuesi/ja e historisë, drejtorja e shkollës, nxënësit.

Burimet kryesore të informacionit

Teksti, vepra “Ilirët” e autorit Neritan Ceka, vepra “Historia e qytetërimit shqiptar” e autorit Kristo Frashëri, Muzeu Arkeologjik, internet.

Baza materiale:

- letra të bardha,
- kartonë,
- lapustila,
- foto,
- ngjites etj.

Metodologjia

Punë në grupe/ vizitë mësimore/hulumtim

Tematika e orëve të planifikuara

Ora e parë	Ora e dytë	Ora e tretë
Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve.	Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.	Prezantimi i materialit të përgatitur.

<p>Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Diskutojnë dhe përcaktojnë çështjet ku do të fokusohet projekti, burimet e informacionit dhe metodën/at e punës;</p> <p>Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.</p>	<p>Në vazhdim të punës evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre;</p> <p>Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës/e të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.</p>	<p>Në përfundim të projektit, bëhet paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet në mënyrë elektronike ose me anë të posterave/ fletë palosjeve/ dokumentarëve/ muzeut virtual etj., sipas vendimarrjes së grupit;</p> <p>Dorëzohet produkti;</p> <p>Diskutohen dhe debatohet në klasë lidhur me përfundimet e arritura;</p> <p>Vlersimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.</p> <p>Nxënësit/et vlerësojnë argumentet e njëri – tjetrit; mësuesi/ja vlerëson punën e secilit grup me argumentet më bindëse dhe mënyrën se si e kanë paraqitur projektin</p>
---	---	---

Përshkrimi i produktit të projektit

Projekti do të përmbajë informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili grup. Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit.
- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik poëer point, nëse është produkt prezantohet produkti etj.)
- Konkluzione të projektit.

Nëpërmjet këtij projekti nxënësit do të demostrojnë njohuri/ shprehi/aftësi e qëndrime për tezat mbi origjinën e ilirëve, shtrirjen e tyre, organizimin fisnor, rolin dhe rëndësinë e qyteteve, figurat historike, mënyra e jetesës, besimi dhe kultura te ilirët.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës së mëposhtme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Përdorimi i saktë i koncepteve historike.
- Përdorimi i saktë i burimeve historike.

- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohej dhe të kuptohej qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

Projekti vlerësohet me 15 pikë. Për të vlerësuar projektin përdoren kriteret e mëposhtëme

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Projekti	30
Diskutimi dhe përzgjedhja e çështjeve që do të trajtohen në projekt.	5
Kontributi personal dhe në grup	5
Aksesimi i burimeve të informacionit dhe përzgjedhja e burimeve të testuara të informacionit.	5
Përzgjedhja e objekteve arkeologjike dhe mbajtja e saktë e shënimeve në muze	5
Përmbajtja e projektit është fokusuar në çështjet e përcaktuara: roli dhe rëndësia e fiseve dhe qyteteve ilire, tezat mbi origjinën e ilirëve, objektet dhe zonat arkeologjike dëshmi e qytetërimit ilir, vazhdimësia iliro-shqiptare, qytetërimi ilir pjesë e trashëgimisë sonë kulturore dhe ndikimi i tij në turizëm.	5
Origjinaliteti i punimit	3
Prezantimi i projektit	2

Shembull 8. Projekti kurrikular vjetor

Tema: Rilindja Shqiptare, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekujve XIX dhe fillimit të shekullit XX

Kohëzgjatja: 6 orë mësimore

Klasa/t pjesmarrëse: 7A, B, C, D

Rezultatet e parashikuara të nxënësve:

- Harton, shtron pyetje për të shqyrtuar, për të analizuar veprimtaritë e rilindasve shqiptare për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare;
- diskuton për të komunikuar informacionin, konceptet dhe idetë;
- shfrytëzon burimet të testuara dhe të dhënat historike për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve “Rilindje Shqiptare”, “ndërgjegje kombëtare”;
- ndërlidh temën e projektit me njohuritë për periudhën e Rilindjes Europiane dhe ndikimin e saj tek elita intelektuale shqiptare;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në burime;
- vlerëson ndikimin e iluminizmit në Rilindjen shqiptare;

- vlerëson rilindësit iluministë: Naum Veqilharxhi, Pasko Vasa, Jani Vreto, Hoxha Tahsin; Naim e Sami Frashëri, Zef Jubani.
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar prezantimin e temës së dhënë;
- organizon dhe prezanton faktet, argumentet, gjetjet, përfundimet e nxjerra nga hulumtimi.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit: Iluminizëm, Rilindje Europiane, Rilindje Kombëtare Shqiptare, ndërgjegje kombëtare, 29elite intelektuale, lëvizje mbarëkombëtare.

Partnerët: Anëtarë të komunitetit që lëvrojnë në fushën e arteve dhe letërsisë.

Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.

Burimet kryesore të informacionit: Teksti, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi 3, faqe 2249, 2250 (shtylla e dytë) Interneti, Kompjuter, DVD, Laptop, Video-projektor USB Flash-drive, vepra të shkruara nga rilindasit tanë.

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- **Ora 1:** Diskutimi i temës së projektit dhe përcaktimi i tematikave të vecanta dhe krijimini grupeve të punës
 - **Ora 2:** Bisedë me studiues të letërsisë
 - **Ora 3:** Hulumtim mbi dokumentet historike dhe letrare
 - **Ora 4:** Hulumtim në internet
 - **Ora 5:** Përgatitja e informacionit për prezantim
 - **Ora 6:** Prezantimi i projektit
- **Përshkrimi i produktit të projektit** (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- Nëpërmjet këtij projekti nxënësit do të demostrojnë njohuri/ shprehje/aftësi e qëndrime për idetë, synimet dhe përmbajtjen e Rilindjes Shqiptare, shtrirjen kohore dhe gjeografike, periodizimin dhe pasojat e saj, Kontributi i Rilindjes në formësimin dhe konsolidimin e ndërgjegjes kombëtare, ndikimi i Iluminizmit European te Rilindja Kombëtare Shqiptare, kontributin e figurave më të rëndësishme të Rilindjes sonë Kombëtare ku do të vecohen: Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Jani Vreto, Hoxhë Tahsini, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Zef Jubani.
 - Prezantimi i projektit do të realizohet në formën e dokumentarit, materialit në power point/ albumit ose posterit. Pra, grupet do të përzgjedhin një nga format e prezantimit.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Tabela e kriterëve për vlerësimin e projektit

Skema e vlerësimit

Projekti kurrikular vjetor				
Periudha	Kriteri	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Periudha 1	- Strukturon pyetësorët/intervistat në përmbushje të tematikës dhe mbledhjes së të dhënave.	Formulon pyetje të cilat nuk e adresojnë problemin konkret dhe grumbullimin e të dhënave. (2 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë pjesërisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (4 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë tërësisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (6 pikë)
	- Identifikon dhe përdor burime të larmishme për hulumtimin e informacionit.	Përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit. (2 pikë)	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit pa vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. (4 pikë)	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit duke vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gadishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		5 pikë	10 pikë	15 pikë
Periudha 2	- Përpunon informacionin e mbledhur bazuar në të dhëna.	Identifikon informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime të thjeshta. (2 pikë)	Përshkruan informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime bazuar në të dhëna. (4 pikë)	Analizon dhe interpreton informacionin dhe të dhënat historike për të nxjerrë përfundime dhe evidentuar kufizimet. (6 pikë)
	- Organizon draft-produktin në përmbushje të tematikës dhe zgjidhjes së problemit.	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin, por nuk ofrojnë zgjidhje. (2 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje të pjesshme. (4 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë tërësisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit por nuk	Bashkëpunon me grupin	Demonstron gadishmëri për

	(2 pikë)	është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		5pikë	10 pikë	15 pikë
Periudha 3	- Trajton tematikën në funksion të zgjidhjes së problemit.	Identifikon zgjidhje për çështjen historike aktuale pa u thelluar në pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (2 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen historike aktuale dhe identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (4 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen historike aktuale dhe analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (6 pikë)
	- Prezanton informacionin duke përdorur kronologjinë, gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm historik	Organizon me vështiësi informacionin, pa e përshtatur për audiencën e synuar. (2 pikë)	Organizon informacionin, pa e përshtatur atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor kronologjinë, fjalorin dhe terminologjinë historike. (4 pikë)	Organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor kronologjinë, fjalorin dhe terminologjinë historike. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup për prezantimin e produktit përfundimtar	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gadishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		5pikë	10pikë	15 pikë

Shembull 9. Projekti ndërlëndor vjetor

- **Tema e projektit:** Jeta e përditshme në Shqipërinë e viteve 1945-1990
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** 6 orë
- **Histori:** 2 orë
- **Art pamor:** 2 orë
- **Qytetari:** 2 orë
- **Klasa/t pjesëmarrëse:** 8 A, B, C
- **Rezultatet e të nxënit:**
 - Harton dhe drejton pyetje (pyetësor);
 - Krahason aspektet e jetës së përditshme të njerëzve të shtresave të ndryshme;
 - Evidenton aspekte të jetës së përditshme në diktaturë;
 - Analizon tiparet e diktaturës komuniste për të përshkruar të drejtat dhe liritë e mohuara;

- Përshkruan njeriun e realizmit socialist nëpërmjet pikturave dhe skulpturave;
- Jep gjykimin e tij për mënyrën e jetesës në diktaturë;
- Organizon informacionin;
- Prezanton informacionin me një nga format e propozuara;
- Përdor njohuritë e TIK-ut për të prezantuar projektin;

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit: diktaturë, jetë e përditshme, art, shtresa, të drejta të mohuara, realizëm socialist.

Përshkrimi projektit

Ora e parë

Ndahen në grupe, propozojnë çështjet që do të trajtohen në projekt. Përgatisin pyetëtorin që do të zhvillojnë me njerëz që u përkasin profesioneve të ndryshme dhe që kanë jetuar në diktaturë.

Ora e dytë

Vizitë në Galerinë Kombëtare të Arteve për të parë veprat e Realizmit Socialist ku nxënësit njihen me veprat e kësaj periudhe dhe mbajnë shënime për mënyrën si pasqyrohej njeriu dhe jeta shoqërore.

Ora e tretë

Nxënësit vendosen në bibliotekën e shkollës për të shfrytëzuar burimet e informacionit (vepra historike dhe letrare) dhe përzgjedhin informacionin e duhur.

Ora e katërt

Nxënësit përdorin sallën e informatikës për të kërkuar dhe përzgjedhur informacion për projektin;

Ora e pestë

Mësuesi/ja jep sugjerime mbi shpërndarjen e punës brenda grupit dhe ndajnë detyra brenda grupit.

Nxënësit përpunojnë informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, veprat e shkruara dhe interneti.

Raportohen veshtirësitë dhe bëhen sugjerime nga mësuesi/ja dhe nga nxënës/e të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme

Ora e gjashtë

Në orën e prezantimit të projektit marrin pjesë të gjithë mësuesit e angazhuar në projekt.

Në përfundim të projektit, bëhet paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet me anë të posterave/power point/ dokumentarëve/ muzeut virtual etj., sipas vendimarrjes së grupit;

- Diskutohen dhe debatohet në klasë lidhur me përfundimet e arritura;
- Nxënësit/et vlerësojnë argumentet e njëri – tjetrit;
- Mësuesi/ja vlerëson punën e secilit grup.

Personat përgjegjës për realizimin e projektit: Mësuesi/ja e historisë, Artisti pamor, Qytetarisë, drejtorja e shkollës, nxënësit.

Burimet kryesore të informacionit: Teksti, Përmbledhje «Të murosur» Jeta nën diktaturë dhe mungesa e lirisë “Muri dhe mungesa e lirisë”; <http://www.gazetadita.al/nje-dite-ne-komunizem/>, Libri “Ora me rërë”, i autores Vera Bekteshi,

Metodologjia: Punë në grupe/ vizitë studimore/ hulumtim/

Fazat e projektit:

Faza përgatitore (ora e parë)

Faza e dytë: Hulumtimi (ora e dytë, e tretë dhe e katërt)

Faza e tretë: Përzgjedhja dhe organizimi i informacionit (ora e pestë)

Faza e katërt: Prezantimi i projektit (ora e gjashtë)

Përshkrimi i produktit të projektit: Njëpërmjet këtij projekti nxënësit do të demostrojnë njohuri/ shprehje/aftësi e qëndrime për evidentimin e aspekteve të jetës në shoqëri komuniste shqiptare, për të analizuar dokumentet e shkruara dhe ato vizuale për të kuptuar mungesën e lirive dhe të drejtave të individit, veçoritë e realizmit socialist në art, mënyrën se si pasqyrohej jeta shoqërore.

Vlerësimi i nxënësve:

Projekti vlerësohet me 50 pikë. Projekti ndërkurrikular vjetor vlerësohet sipas fazave të zhvillimit të tij. Për të vlerësuar projektin përdoren kriteret e mëposhtme:

- Kontributi personal dhe në grup
- Përmbajtja e projektit është e fokusuar në çështjet e përcaktuara
- Përdorimi i burimeve të testuara të informacionit
- Përzgjedhja e informacionit dhe organizimi i tij në favor të tezës që mbështet
- Origjinaliteti në punim
- Prezantimi i projektit

6. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënësve janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t’u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

6.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën e historisë përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të

orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqëndruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

6.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor, duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim.

Tabela: Shembull planifikimi vjetor në lëndën e historisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: HISTORI

KLASA: 9

70 ORË

Tabela: Model planifikimi vjetor në lëndën e historisë

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor	Janar - Mars	Prill - Qershor
	26 orë	24 orë	20 orë
I.Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare	Periudha parahistorike (Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare), Qytetërimi ilir (Iilirët dhe organizimi ekonomik dhe shoqëror i tyre, mbretëritë	Rilindja Kombëtare Shqiptare (shoqëritë shqiptare në diasporë, revolucioni i turqve të rinj dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1908-1912), kuvendi i Vlorës dhe shpallja e	Lufta e Dytë Botërore 1939-1944 (Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, rrjedhojat e saj, Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Luftës Dytë Botërore), Regjimit komunist në Shqipëri 1944-1990
II.Territoret shqiptare në mesjetë (shek.	ilire, shteti i Epirit, mbretëria Dardane, territoret ilire nën		

<p>V-fundi I shek. XV)</p> <p>III.Territoret shqiptare nën Perandorinë Osmane (fundi i shek. XV-fillim i shek. XX)</p> <p>IV.Shqipëria dhe shqiptarët në vitet 1912 – 1939.....</p>	<p>Perandorinë Romake, gjuha, arti, kultura dhe besimi tek ilirët, ndikimi i kulturave fqinje greke dhe romake në kulturën ilire), Territoret shqiptare nën Perandorinë Bizantine (Territoret shqiptare gjatë Mesjetës së hershme (shek.V-X)</p>	<p>pavarësisë së Shqipërisë,veprimtarë të RilindjesKombëtare Shqiptare,</p> <p>Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912-1920 (shteti shqiptar në vitet 1912-1914, Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918), Konferenca e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës,</p> <p>Shqiptarët në përpjekje për të konsoliduar shtetin</p>	<p>(vendosja e regjimit komunist në Shqipëri, Shqipëria gjatë viteve 1944-1948, ndërtimi i partisë-shtet në Shqipëri, sipas modelit stalinist (1948-1953), Shqipëria gjatë viteve 1954-1961, Shqipëria gjatë viteve 1961-1978,vetizolimi i shtetit shqiptar dhe kriza e regjimit komunist (1978-1990), Kosova në vitet 1945-90 (Shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1990, jeta e përditshme në Shqipërinë komuniste, opozitarët e regjimit komunist)</p>
---	---	---	--

6.3.Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimn e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) *Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe*

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënës të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënës, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b) *Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të lëndës*

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxënës nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c) *Numri rendor*

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d) *Kapitulli*

Në këtë rubrikë shënohen kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e) *Tema mësimore*

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t'u planifikuar

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e veprimtarive praktike që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e historisë si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç.
- orët e projektit/eve kurrikulare që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e historisë si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç.
- orët e testeve përmbledhëse për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 teste përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Testet përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit e tij, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

Opsionale

- orët e vlerësimit të portofolit për t'u krijuar mundësi nxënësve të prezantojnë punimet e tyre dhe të shkëmbejnë eksperiencë me njëri – tjetrin. Në lëndën e historisë mësuesi mund të planifikojë 1-2 orë vlerësimi portofoli në varësi të kushteve specifike për çdo periudhë. Mësuesi planifikon vlerësimin e portofolit në planifikimin e periudhës, por ai është fleksibël për ta ndryshuar këtë planifikim dhe ta realizojë vlerësimin e portofolit në kohën kur nxënësit i kanë përfunduar detyrat e tyre, sipas afateve të përcaktuara nga mësuesi.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënësve si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Tabela 1 Model planifikimi i orëve mësimore për një periudhë

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe				
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: shqyrton, analizon, parashtron pyetje, për të argumentuar, diskutuar dhe komunikuar informacionin historik si dhe konceptet dhe idetë historike.</p> <p>Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë, për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndjafoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.</p> <p>.....</p>				
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave historike				
<p>Kërkimi historik: identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave dhe reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.</p>				
Nr.	Tematika	Organizimi i temave me dy orë të njëpasnjëshme	Temat mësimore
1	Periudha parahistorike	Periudha parahistorike
2			Qytetërimi ilir
3		Qytetërimi ilir	Mbretëritë ilire
4			Shteti i Epirit
.....
11	Territoret shqiptare nën Perandorinë Bizantine	Territoret shqiptare gjatë Mesjetës së Hershme (shek. V–X)
12			Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror në fshatin e qytetit mesjetar (shek. X–XIV)
13		Vepërtari praktike	Vepërtari shkollor
14			Vepërtari shkollor (Projekt shkollor ose konkurs në rang shkolle ose eskursion etj.)

17		Projekti kurrikular	Projekt (1)²
20			Projekt (2)
22	Test përmbledhës	Test përmbledhës - Tremujori i parë
23		Rilindja Kombëtare Shqiptare	Lidhja Shqiptare e Prizrenit (qershor 1878-prill 1881) 3)	
24		Diskutimi dhe vlerësimi i portofolit	<i>Diskutim dhe vlerësim i portofolit</i>
25			<i>Diskutim dhe vlerësim i portofolit</i>
.....

6.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
Mësimi përqëndrohet pothuajse te përmbajtja.	Mësimi përqëndrohet mbi proceset dhe veprimtaritë.
Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke i vënë theksin të bashkëpveprimi i nxënësve.


Model planifikimi i orës mësimore Shembull 1

²Orët e projektit mund të zhvillohen edhe të shpërndara. Në varësi të mundësive dhe fleksibilitetit që ka, mësuesi mund të planifikojë 2-3 orë projekti kurrikular

Fusha Fusha Shoqëria dhe mjedisi	Lënda Histori	Shkalla III	Klasa 6
Tema mësimore Zhvillimi i qyteteve në mesjetë dhe Lindja e rajoneve dhe bankave		Situata e të nxënit Zhvillimi i qyteteve, rajoneve tregtare dhe bankave në mesjetë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi në fund të orës së mësimi: - Evidenton faktorët që çuan në lindjen e qyteteve mesjetare, rajoneve tregtare dhe bankave; - Përshkruan qytetin mesjetar dhe e dallon atë nga qytetet e antikitetit dhe kohës së sotme; - Vlerëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar dhe lindjen e bankave; - Dallon elementet e vetadministrimit të qyteteve mesjetare; - Evidenton tiparet e artit, kulturës dhe arsimit në shek. XI-XIV.		Fjalë kyç Republikë e pavarur, katedrale, vetëqeverisje, flotë tregtare, shkëmbim i mallrave, rajon tregtar, panair, bankier, saraf, heretik	
Burimet Informacioni që nxënësit kanë, teksti, pamje dhe foto të qyteteve antike, mesjetare e të ditëve të sotme. Foto të monedhave dhe bankave. Hartë e Evropës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Gjeografi, Qytetari	
Organizimi i orës së mësimi (Dy orë të njëpasnjëshme)			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (stuhi mendimi) (5-7 minuta)			
<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja pyet nxënësit rreth njohurive të tyre për ndryshimet në ekonominë mesjetare: - Cilat degë të ekonomisë lindën në mesjetë? - Cilat janë format e shkëmbimit në mesjetë? - Çfarë ndryshimesh solli lindja e parasë? - Pse themi që qytetet ndikuan në jetën e fshatit? 			
Ndërtimi i njohurive të reja			
Parashkimi me terma paraprakë			
<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Qytet tregti fshat bankë bujqësi para zejtari - Nxënësit, në mënyrë individuale do të shkruajnë fjali me këto terma duke bërë lidhjen mes tyre. - Lexohen fjalitë e ndërtuara - Diskutohen përgjigjet dhe evidentohen fjalitë që kanë lidhje me temat që do të zhvillohen. 			
Punë në grupe			
<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja mbledh fotografitë që nxënësit kanë sjellë për temat që do të zhvillohen sot. - Mësuesi/ja i ndan nxënësit në 6 - 7 grupe, i shpërndan fotot e mbledhura (çdo grup një foto) dhe kërkon që të evidentojnë elementet përbërëse të fotove. - Pas përfundimit të punës një përfaqësues për çdo grup prezanton foton dhe punën e bërë. 			

Organizuesi grafik

- Nxënësit, me ndihmën e mësuesit, gjejnë dallimet mes qytetit në lashtësi, mesjetë dhe sot, i shënojnë në organizuesin grafik



Lexim i tekstit

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin dhe të nënvizojnë informacionin e paqartë për ta dhe sqaron termat, konceptet dhe informacionin.

Punë në çifte

- Mësuesi/ja i ndan detyrat për çdo çift dhe i kërkon që për pjesët e caktura njëri të hartojë pyetje ndërsa tjetri të gjejë përgjigjen.
- Nxënësit lexojnë pyetjet dhe përgjigjet.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

- Mësuesi fton nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:
- Kur zhvillohen dhe lulëzojnë qytetet mesjetare?
- Pse ndarja e zëjtarisë nga bujqësia sollti lindjen e qyteteve?
- Trego në hartë qytetet që lulëzuan në mesjetë
- Cilat ishin shkaqet e luftës së qyteteve me feudalët?
- Pse vetëqeverisja e qyteteve u kufizua kur pushteti mbretëror filloi të forcohej dhe centralizohej?
- Ç'kuptoni me termat: Republikë e pavarur, katedrale, vetëqeverisje, flotë tregtare, shkëmbim i mallrave, rajon tregtar, panair?
- Trego në hartë rajonet tregtare.
- Cilat ishin shkaqet që sollën lindjen e bankave?
- Cili ishte dallimi mes një sarafi dhe një bankieri?
- Pse themi se shek XIII-XIV po krijohet tregtia ndërkombëtare?
- Pse arti e kultura kishte karakter fetar në shek XI-XIV?
- Përshkruaj lidhjen mes ndarjes së zëjtarisë – qyteteve mesjetare; parasë -tregjeve ndërkombëtare - bankave.

Vlerësimi

Gjatë zhvillimit të këtyre temave, vlerësimin e nxënësit e mbështes në aftësinë dhe në punën e tij. Vlerësimi i nxënësit kryhet sipas përmbushjes së niveleve të arritjeve:

Niveli 2

- Evidenton ndonjë nga faktorët që çuan në lindjen e qyteteve mesjetare, rajoneve tregtare dhe bankave
- Dallon qytetin mesjetar nga qytetet e antikitetit dhe të kohës së sotme

- Tregon ndonjë nga faktorët që ndikuan në lindjen e qyteteve mesjetare.
- Tregon ndonjë nga arritjet në art, kulturë dhe arsim në shek.XI-XIV
- Tregon në hartë ndonjë rajon tregtar

Niveli 3.

- Dallon disa tipare të qyteteve mesjetare dhe e përshkruan atë
- Dallon disa nga elementet e vetadministrimit të qyteteve mesjetare
- Bën lidhjen mes ndarjes së punës dhe lindjes së qyteteve mesjetare
- Përshkruan disa nga ndryshimet në qytetet mesjetare në shek. XI-XIV
- Përkufizon dhe përdor konceptet “rajon tregtar”, “bankë”
- Interpretton faktet dhe prezanton me ndihmë punën e bërë individualisht apo në grup

-Niveli 4.

- Përkufizon konceptet “Rajon tregtar”, “Bankë”
- Përcakton kohën e lindjes së qyteteve dhe zhvillimit të tyre
- Përcakton elementet e vetadministrimit të qyteteve mesjetare
- Bën lidhjen shkak –pasojë mes ndarjes së punës dhe lindjes së qyteteve mesjetare si edhe mes zhvillimit të qyteteve dhe lindjes së rajoneve tregtare dhe bankave
- Vlerëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar dhe lindjen e bankave
- Vlerëson arritjet në art, kulturë dhe arsim në shek. XI-XIV
- Interpretton faktet dhe prezanton punën e bërë individualisht apo në grup

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit që vlerëson.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ese me temë “Ajri i qytetit të bën të lirë”

7. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E HISTORISË

Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënie - nxënies. Vlerësimi përdoret:

- për të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- për të matur arritjet e nxënësve;
- për të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënie;
- për të raportuar arritjet;
- për t’u dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre.

Vlerësimi mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënit të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësit dhe mund të integrohet në të nxënit normal të nxënësve.

Qëllimi i vlerësimit: Qëllimi kryesor i vlerësimit është *përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve* nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit *mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën* e arritjes së rezultateve të të nxënësve bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi i nxënësve kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar (vlerësimi për të nxënësve) (40%);
- vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënësve) (40%)
- vlerësimin i portofolit lëndor të nxënësve (20%).

7.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënësve)

- Vlerësimi për të nxënësve shpesh quhet vlerësim formativ dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit. Kjo mundëson të shihni se ku kanë nxënësve probleme dhe për të dhënë reagime të menjëhershme të cilat do t'i ndihmojnë nxënësve tuaj të mësojnë më mirë. Gjithashtu, vlerësimi për të nxënësve ju ndihmon të planifikoni punën tuaj për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. *Shpesh ky vlerësim është informal* dhe nxënësve mund të mbajnë shënime vetë mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënësve i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimin të kaluar.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësve, vetëvlerësimin e nxënësve, vlerësimin e nxënësve nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.* përgjatë një periudhe.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësve gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënësve (vlerësimi i vazhduar). *Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënësve (vlerësimi të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënësve e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.* Pra, vlerësimi për të nxënësve nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënësve dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënësve)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë *të njëjtin dokument*. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënësve).

- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.
- Fletoren personale (evidencën) mësuesi **e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të**, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur **simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme**, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N₃ ose N₄**), si dhe **konceptin/konceptet përkatëse** për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrateshtëpisë apo të klasës etj., **vlerësohen me simbole**. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënës, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset **vetëm** në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë **rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur** në fletoren e tij personale.
- Fletorja personale (evidenca) **është objekt monitorimi, por nuk** duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi **mban përgjegjësi për fletoren personale** dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t'i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

Shembull: Histori (klasa IX.)

Periudha: shtator - dhjetor

Nr.	Nxënësi	Data/muaji						Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
		19.09	19.09	03.10	03.10	07.11	07.11	
1	Alisa Kodra	✓						N3.Epoka e gurit
				++				N4.Mbretëria Ardiane
							++	N.4. Kultura e Komanit

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbljedhëse (NVv).

- Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra **NVv është 10**. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

7.2. Vlerësimi i të nxënit (testi përmbljedhës)

Vlerësimi i të nxënit ndryshe quhet vlerësim përmbljedhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

Si dhe kur realizohet testi/detyra përmbljedhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me test ose me detyrë përmbljedhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbljedhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbljedhëse planifikohet nga mësuesi. kur përmbyllet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është **i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë**.
 - Testi/detyra përmbljedhëse është 45 minuta.
 - Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbljedhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
 - Testi/detyra përmbljedhëse **jo domosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
 - Në momentin kur mësuesi **vlerëson testet/detyrat përmbljedhëse, i vendos** notat në regjistër.

- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** testet ose detyrat përmbledhëse.

7.3 Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra hulumtuese, krijime ose zbatime të ndryshme, projekte të nxënësve etj., që zhvillojnë *kompetencat kyç dhe lëndore*. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësit. ***Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë:***

📁 Projektin ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.

📁 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

(P.sh., në lëndët me 1-2 orë në javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, ndërsa lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël). Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

*Kujdes! Detyrat **NUK** duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.*

Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kritere vlerësimi duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit ***nuk janë objekt monitorimi.***

- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund **të planifikohet si orë e veçantë** në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.
- Mësuesi duhet të kujdeset që **të mos mbingarkojë nxënësin me detyra** në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit **jodomosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.
- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me **vlerësimin edetyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij**, notat e portofolit i vendos në regjistër.
- Mësuesi duhet t'i udhëzojë nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t'i mbajë vetë këto detyra.

Shembull portofoli në lëndën e historisë

Në lëndën e historisë, mësuesi mund të planifikojë të paktën 3 detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular vjetor dhe ose me shtrirje tremujore). Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 3 detyra për portofolin e periudhës së dytë, i cili do të ketë gjithsej 30 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët për secilën detyrë. (Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

Klasa e gjashtë

Tremujori i dytë

Detyrat për portofol

- | | |
|--|---------|
| 1. Ndërton hartën e Evropës mesjetare dhe vendos shtet-kombet | 5 pikë |
| 2. Lidhja e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV. | 10 pikë |
| 3. Projekt me temë “Jeta dhe veprimtaria e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu”.
Faza e dytë. | 15 pikë |
- Në detyrën e parë me temë “Ndërton hartën e Evropës mesjetare dhe vendos shtet-kombet” e cila është e karakterit zbatues vlerësohet saktësia e paraqitjes së informacionit (ndërton hartën e kontinentit evropian, përcakton shtet kombet dhe i vendos ato në hartë duke shënuar emërtimet e tyre.
 - Në detyrën e dytë vlerësohet përdorimi i burimeve të informacionit, përzgjedhja e informacionit për të bërë lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV, pra vlerësohet kërkimi, përzgjedhja e informacionit, origjinaliteti, krijimtaria.

- Në detyrën e tretë (fazën e dytë të projektit) vlerësohet përzgjedhja e burimeve të informacionit dhe materialeve që do të prezantohen, puna individuale dhe bashkëpunimi në grup.

Mësuesi përcaton tabelën e pikëve (si rasti i testeve).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>7	8-11	12-15	16 - 19	20-23	24-27	28-30

Në shembullin e mësipërm nxënësi vlerësohet nga mësuesi si më poshtë:

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Pikë	4 pikë	9 pikë	12 pikë	25 pikë

Vlerësimi me pikë i këtij për portofolin e këtij nxënësi është nota 9 (nëntë)

Shembull portofoli:

Histori 7

Tremujori i parë

Detyrat e përzgjedhura për portofol dhe pikët/peshat për cdo detyrë janë:

- *Ndërtimi i hartës së zbulimeve gjeografike duke vendosur emrat e zbuluesve, rrugët e ndjekura nga ata, vendet e zbuluara dhe kohën kur u zbuluan.*

10 pikë

- *Hulumtimi për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulinari dhe kulturë në qytetin/ zonën ku jetojmë.*

15 pikë

- *Projekti kurrikular vjetor me temë: Rilindja Shqiptare, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekujve XIX dhe fillimit të shekullit XX. (Faza e parë- përcaktimi i grupeve përcaktimi i çështjeve që do të trajtohen në brendi të tij, përzgjedhja e burimeve.*

15 pikë

Rezultatet e të nxënit:

- Përcakton rrugët që ndoqën zbuluesit për të zbuluar territore të reja
- Bën lidhjen mes zbuluesve dhe territoreve që ata zbuluan
- Përcakton kohën kur u zbuluan territoret e reja
- Përdor njohuritë e marra në gjeografi për ndërtimin e hartës së zbulime gjeografike
- Akseson burime të testuara për të gjetur informacion për gjurmët e trashëgimisë osmane në zonën ku jeton
- Përzgjedh informacionin e kërkuar
- Jep mendimin e tij/saj për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulturë dhe kulinari

- Harton pyetje
- Zhvillon intervista
- Diskuton për çështjet ku të fokusohet projekti
- Punon individualisht dhe në grup
- Prezanton gjetjet duke bërë lidhjet shkak-pasojë dhe i shpjeguar ato

Grupimi i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes

Kërkesat e nivelit 2 (nota 5-6)

Nxënësi në këtë nivel:

- Identifikon ndonjë nga zbuluesit dhe bën ndonjë nga lidhjet mes tyre dhe territorit të zbuluar prej tyre
- Identifikon ndonjë nga vitet në të cilat u zbuluan territoret e reja
- Identifikon ndonjë nga burimet e informacionit
- Identifikon ndonjë nga ndikimet e trashëgimisë osmane në kulinari apo jetën e përditshme

Kërkesat e nivelit 3 (nota 7-8)

Nxënësi në këtë nivel:

- Vendos në hartë disa nga zbuluesit dhe bën lidhjet mes tyre dhe territoreve që zbuluan
- Shënon disa nga vitet e zbulimeve gjeografike
- Përdor disa nga konceptet historike
- Akseson disa nga burimet informacionit
- Përzgjedh informacion për disa nga ndikimet e qytetërimit osman në zonën ku jeton
- Harton disa nga pyetjet për intervistën
- Drejton pyetje
- Jep mendimin e tij/saj jo gjithmonë të mbështetur në argumente
- Prezanton gjetjet duke shpjeguar disa nga lidhjet shkak-pasojë

Kërkesat e nivelit 4 (nota 9-10)

- Ndërton saktë hartën e zbulimeve gjeografike duke bërë lidhjet mes zbuluesve, territoreve që zbuluan dhe vitet në të cilat i zbuluan
- Përzgjedh burimet të testuara informacioni
- Përzgjedh informacionin e duhur për detyrën e dhënë
- Jep mendimin e tij/saj për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulturë dhe kulinari
- Harton pyetje
- Zhvillon intervista;
- Prezanton gjetjet duke shpjeguar lidhjet shkak –pasojë
- Përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik për të shpjeguar të shkuarën

Vlerësimi i portofolit me notë

Mësuesi përcaton tabelën e pikëve (si rasti i testeve).

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

Në shembullin e mësipërm nxënësi vlerësohet nga mësuesi si më poshtë:

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Pikë	7 pikë	10 pikë	15 pikë	32 pikë

Vlerësimi me pikë i këtij për portofolin e këtij nxënësi është nota 9 (nëntë).

7.4 Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NTP)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NVP)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

7.5 Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”. Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

Shënim: Nxënësi ka 9 nota në regjistër për çdo lëndë deri në përfundim të vitit shkollor.

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVV), bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NTP) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVP) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).

$$(NVV \times 0.4) + (NTP \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Shembull 1: Histori, klasa VII

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NTP	NV P	NV V	NTP	NV P	NV V	NTP	NV P	NV V	NTP	NVP	
6	7	8	8	7	9	8	7	9	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës. Përshkrimi u referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përbushjen e kompetencave të lëndës.

7.6 Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet të përdorë nivelet e arritjes kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje në rezultatet e të nxënit. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilën nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar.

Nxënësit gjithmonë duhet të kenë një kopje të niveleve të arritjes në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë për të arritur në një nivel apo për të marrë një notë të mirë në një detyrë. Nivelet e arritjes ju ndihmojnë në shënimet tuaja për të orientuar nxënësit të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen. Për të siguruar interpretim korrekt të niveleve të arritjeve kur mësuesi vlerëson nxënësit, duhet që të gjithë nxënësit të përfundojnë të njëjtën detyrë nën të njëjtat kushte dhe të gjithë mësuesit të përdorin të njëjtat nivele arritjesh për vendosjen e notës.

Mësuesit pastaj mund të krahasojnë punën e nxënësve dhe të vijnë në një të kuptuar të përbashkët të niveleve të arritjeve.

(Shih zbërthimin e niveleve të arritjeve te modeli i planifikimit ditor, portofol, projekti apo te modeli i testit)

7.7 Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi i ndihmon ata të kuptojnë më shumë se si të mësojnë. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre (vetëvlerësimin) ose punën e të tjerëve (vlerësimi i

nxënësit nga nxënësi). Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia për të vlerësuar të nxënit e tyre dhe të nxënit e të tjerëve sipas kriterëve të përcaktuara.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi:

- vazhdon ciklin e të mësuarit duke bërë pjesë vlerësimin e të nxënit;
- u tregon nxënësve pikat e forta dhe ku ata duhet të përmirësohen;
- angazhon nxënësit në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit;
- u mundëson nxënësve që të jenë përgjegjës për mësimin;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes.

Vlerësoni në klasë - përdorni kohën e klasës për të kryer dhe për të vlerësuar detyrat e klasës, detyrat e shtëpisë, detyrat e portofolit, projektet, përgjigjet me gojë, prezantimet, kuizet dhe testet (me zgjedhje të shumëfishta, e saktë/ e gabuar, me çiftime, po/jo). Ky vlerësim mund të kryhet fare mirë me anë të nxënësve, është vlerësim zhvillues dhe me reagime të menjëhershme. Vlerësimet në klasë janë më të shkurtra, marrin më pak kohë për të shënuar dhe janë të dobishme sepse jepen reagime të menjëhershme mbi përparimin e nxënësve.

Zhvendosni përgjegjësinë - prezantoni vetëvlerësimin dhe vlerësimin e nxënësit nga nxënësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për të vlerësuar punën e tyre dhe atë të shokëve të tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi rrit sasinë e reflektimit të nxënësve. Sigurisht mësuesi mund të plotësojë vlerësimin. Nuk është e nevojshme të mbahet shënim për çdo vlerësim apo të vendoset notë për çdo vlerësim. *Vlerësimi është hartuar për të përmirësuar përvoja mësimore për ju dhe për nxënësin, jo vetëm për të “akredituar” nxënësit.*

Ndryshime pozitive që sjell vlerësimi bazuar në kompetenca

Për nxënësit:	Për mësuesit:	Për prindërit:
Siguron informacion për pikat e forta dhe mundësitë për zhvillim.	Siguron të dhëna të hollësishme për aspekte të ndryshme të të nxënit.	Siguron informacion të detajuar dhe specifik për arritjet e fëmijës.
Mbështet dhe nxit procesin e të nxënit.	Krijon mundësi të gjykojë më mirë për arritjet e nxënësve.	Përfshihen në procesin e të nxënit të fëmijës.
Lehtëson nxënësit dhe shmang presionin e notës në mënyrë të vazhdueshme.	Lehtëson vëmendjen e mësuesit nga notat e vazhdueshme duke u përqëndruar më shumë te të nxënit e nxënësve.	Krijon më shumë mundësi për mbështetje rreth të nxënit të fëmijëve të tyre.
Çbën “mitin” e notës.	Shmang subjektivizmin në vlerësim.	Interesohen më shumë për përparimin e nxënësve në vazhdimësi.

Siguron vetëbesim te nxënësit.	Siguron të dhëna nga burime të ndryshme për të motivuar nxënësin.	Vlerësohen jo vetëm arritjet por edhe përpjekjet që bëjnë fëmijët e tyre.
Krijon mundësi për vetëvlerësim dhe forma të larmishme vlerësimi.	Organizimi i veprimtarive gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të mësimin me dy orë të njëpasnjëshme e lehtëson shumë këtë proces vlerësimi.	Prindërit kanë mundësi të japin mendimin e tyre për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Motivon zhvillimin e kompetencave të të nxënësve (kompetencave kyçe dhe lëndore).	Nxit rritjen profesionale të mësuesit.	Zhvillimi i kompetencave kyçe aftëson nxënësit edhe në zgjidhjen e situatave në jetën e përditshme.
Bazohet në nivele arritjesh të njëjta për të gjithë.	Mëuesi është objektiv, transparent dhe objektiv për të gjithë	Bazuar në nivele, prindërit ndërgjegjësohen për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Zhvillon talente dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të tregojnë aftësitë e tyre.	Siguron gjykime dhe mbështet vendimmarrje mbi bazën e të dhënave të shumta që siguron.	Sigurojnë informacione mbi bazën e të dhënave që mësuesi siguron nga burime të ndryshme.
E bën nxënësin më “miqësor” me lëndën.	E bën lëndën më “të dashur” për nxënësin.	I bën shkollën dhe mësuesit më “të pëlqyeshëm” për fëmijët e tyre.

Zhvendosje në “vlerësim”

Nga vlerësimi i fokusuar te ajo që nxënësi nuk di.....	Te vlerësimi i procesit se si nxënësi e ndërton dijen...
Nga përdorimi i rezultateve për të llogaritur notën..	Te përdorimi i rezultateve për të informuar rreth të nxënësve..
Nga vlerësimi vetëm i mësuesit.	Te nxënësi që është i përfshirë në vlerësimin e vazhduar të punës së tij dhe të të tjerëve.
Nga gjykimi i punës që mund të dëmtojë motivimin e nxënësve.	Te përshkrimi i punës që fuqizon dhe motivon nxënësin..

8. KRITERET E HARTIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË TESTIT

Një test është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësve dhe i progresit të nxënësve. Testet janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies - nxënies nëse ata janë të integruar në “rutinën” e klasës dhe nuk trajtohen thjesht si një strategji “përmbledhëse”. Ata u lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies - nxënies. Testet ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe

rezultatet e të nxënit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t'u jepet përshtypja për performancën e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

8.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënit për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të ndryshojnë nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër etj.)

Testet duhet:

- të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxëni;
- të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- t'u krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;
- të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve për të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- të mos ngatërrohen me minitestet të cilat masin rendimentin e orës së mësimit dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish të lëndës mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.

- Është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme; pyetje të strukturuar, me alternativa, pyetje me zgjidhje të shkurtër.
- Pyetjet në test është mirë të rradhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre.
- Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- Gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m. th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

8.2. Hartimi i testit

Hartimi i testit në lëndën e historisë bazohet te bazat metodologjike të hartimit të testeve.

Për hartimin e testit ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- 1) Përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zënë secili koncept kryesor në test) si dhe rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave historike.
- 2) Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, sidoqoftë mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.
- 3) Ndërton tabelën e specifikimit (Tabela e Blue –Printit);

Konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënësve	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....

Pikët total të testit	100% = ... pikë		30% - 40%= ... pikë Ose 35%	40% - 45%= ... pikë Ose 40%	20% - 25% = ... pikë Ose 25%
------------------------------	------------------------	--	---------------------------------------	---------------------------------------	--

Tabela na ndihmon për të marrë këto informacione për përmbajtjen e testit:

- A përmban testi pyetje për të gjitha rezultatet e të nxënëit që përmban programi?
 - Sa pyetje duhet të përmbajë testi për secilin rezultat te nxëni?
 - A është përcaktuar një ekuilibër në përzgjedhjen e pyetjeve që ka testi dhe njohurive brenda temave mësimore?
 - A është specifikuar secili rezultat i të nxënëit sipas tre niveleve të arritjeve të kompetencave lëndore?
- 4) Hartimi i pyetjeve të testit.**
- 5) Hartimi i skemës së vlerësimit (Bazuar ne teoremën e Gausit).**
- Skema e vlerësimit u vjen në ndihmë mësuesve për të bërë vlerësimin e standardizuar për të gjithë nxënësit. Skema shmang çdo lloj fiktiviteti gjatë korrigjimit të testit.
 - Vendosja e pikëve për çdo kërkesë bëhet mbi bazën e çdo hapi që nxënësi ndërmerr gjatë zgjedhjes së kërkesës, të cilat pasqyroheshin qartë në skemën e qortimit.
 - Vlerësimi me pikë i kërkesave që përmban testi është pjesa më e rëndësishme e hartimit të tij. Në vlerësimin përfundimtar merret parasysh dallimi në vlerësimin e nxënësit, i cili përcaktohet nga niveli i arritjeve.
 - Një faktor mjaft i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar është hartimi i saktë i skemës së pikëzimit të testit dhe konvertimi i pikëve në notë sipas teoremës së Gausit.

Hartimi i skemës së vlerësimit (skema e qortimit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindjet	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Skema më e saktë (teorema e Gausit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-8 +8	9-15 +6	16-22 +6	23-28 +5	29-33 +4	34-37 +3	38- 40 +2

Tabela e vlerësimit për një test me 40 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

8.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste mund të paraqiten si më poshtë:

1. Pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë).

- Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trangu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.
- Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
- Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
- Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
- Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
- Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'i referohen të njëjtës kategori.
- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore.
- Vetëm një alternativë është e saktë.
- Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.
- Në përgjithësi rekomandohet të mos përdoren si alternativa shprehjet “asnjë nga të mësipërmet” ose “të gjitha të mësipërmet”.
- Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

Shembull: Më 11 gusht 1789 Asambleja Kushtetuese në Francë shpalli me ligj

- a) Vendosjen e feudalizmit
- b) Vendosjen e kapitalizmit
- c) Heqjen e feudalizmit
- d) Heqjen e kapitalizmit

2. Pyetjet “Po/Jo” ose “e vërtetë/ e gabuar”

- Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.

Shembull: Në fjalinë e mëposhtme vendos gërmën “V” për pohimet e vërteta dhe gërmën “G” për pohimet e gabuara.

Fenikasit shtriheshin në territoret e Libanit të sotëm. _____

3. Pyetjet me çiftim

- Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dyja kollonat, ai do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.

Shembull: Lidh me shigjetë vitet me shekujt në të cilët bëjnë pjesë.

- | | |
|------------------|----------------|
| a) Viti 211 pr.k | Shek. XX |
| b) Viti 365 | Shek. III pr.k |
| c) Viti 1901 | Shek. X pr.k |
| d) Viti 901 pr.k | Shek. IV |

4. Pyetjet me plotësim

- Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë

Shembull 1: Plotëso tabelën duke shënuar një nga arritjet e qytetërimeve të mëposhtme në fushën e ekonomisë.

Qytetërimi	Arritjet
Në Mesopotami	
Në Egjipti	
Fenikas	

Shembull 2: Plotëso fjalinë e mëposhtme.

2 pikë

Perandria Romake e Perëndimit merr fund në shek _____, ndërsa Perandoria Romake e Lindjes do të vazhdojë të ekzistojë edhe për _____ vjet të tjerë.

5. Pyetje të strukturuar

- Strukturimi i një pyetjeje (situatë) është zërthimi i saj në elemente përbërës me karakteristikat kryesore që meritojnë të studiohen.
- Shkalla me të cilën mësuesit do të zërthejnë një pyetje (ose situatë) varet nga natyra dhe kompleksiteti i saj, nga niveli i të mësuarit dhe aftësitë individuale të nxënësve.
- Kur pyetja (situata) është shumë komplekse dhe aftësitë nuk janë të larta duhet të rritet shkalla e strukturimit.
- Një nga funksionet e pyetjeve të strukturuar është që ta mundësojnë lidhjen midis mësimit dhe vlerësimit të arritjes.

- Në një pyetje të strukturuar nxënësit i kërkohet të njihet me informacionin që jepet në trungun e përbashkët të pyetjes dhe më pas t'u përgjigjet një sërë kërkesash që lidhen me përmbajtjen e këtij trangu dhe që testojnë në mënyrë progresive njohuritë e nxënësit rreth çështjes.
- Si rregull niveli i vështirësisë së këtyre pyetjeve vjen duke u rritur.
- Pyetjet duhet të jenë të pavarura nga njëra-tjetra dhe përgjigjia e saktë për një pyetje nuk duhet të varet nga përgjigjia e saktë e pyetjes paraardhëse.

Shembull: Rendit tre nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.

6. Pyetje të hapura

- Këto lloj pyetjesh mund të kenë dsa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe veprimeve përkatëse.

Shembull : Ese argumentuese - Vlerëso figurën e Napoleon Bonapartit

8.4 Model testi

Shembull 1. Testi përmbledhës periudha e parë; 45 minuta; Klasa VI

Tematika	Tema	Konceptet kyçe
<ul style="list-style-type: none"> - Qytetërimet botërore në Antikit. - Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. Krishtit); - Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr.K. – shekullin V ps. K.) 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndarja dhe llogaritja e kohës në histori; - Lindja e qytetërimeve në luginat lumore; - Qytetërimi në Mesopotami; Qytetërimi Egjiptian; - Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt; Parailirët dhe ilirët; - Qytetëri në brigjet e detit Mesdhe; - Qytetërimi grek; - Qytetërimi romak; - Ndërprerja e qytetërimit antik në Europë, fillimi i qytetërimit mesjetar. 	<ul style="list-style-type: none"> - llogaritja e kohës në histori, - qytetërim, - lugina lumore, - kode, - shpikje, - shkrimi dhe llojet e tij, - politeizëm, - etnosi ilir, - popuj të detit; - fenikas; - oligarki; - demokraci; - plebenj; - skllevër; - perandori; - monoteizëm; - letërsi; - dyndje (migrim);

Përcaktimi i rezultateve kryesore të nxënësit që do të testohen dhe grupimi i tyre sipas niveleve:

Rezultatet e nxënësit për njohuritë/aftësitë që do të testohen	Grupimi i rezultateve të nxënësit sipas niveleve të arritjes
---	---

<ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon konceptet; - Identifikon çështje të tilla si: Pse, kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallom arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, kodi hamurabit; - Përcakton cilët ish-in banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë dhe vitin e themelimit të Romës; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Argumenton lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore; - Krahason rolin dhe rëndësinë e shtresave shoqërore (demosi dhe plebnjtë) në Athinën dhe Romën e lashtë; - Prezanton pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit. 	<p>Niveli 2 (nota 5-6)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallon ndonjë nga format e qeverisjes dhe e përkufizon atë; - Përcakton se kodi Hamurabit bazohej në ligj; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallon ndonjë nga arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen ndonjë nga veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton ndonjë nga banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton ndonjë nga vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; <hr/> <p>Niveli 3 (nota 7-8)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon çështje të tilla si: kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon disa nga elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallon disa nga arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen disa nga veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon disa nga konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton ndonjë nga banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme parailire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë ; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Argumenton në mënyrë të pjesshme lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - Prezanton disa nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.
	<p>Niveli 4 (nota 9-10)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon çështje të tilla si: Pse, kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallon arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike në brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton cilët ishin banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë kur u themelua Roma - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Argumenton lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore; - Krahason rolin dhe rëndësinë e shtresave shoqërore (demosi dhe plebnjtë) në Athinën dhe Romën e lashtë; - Dallon pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.

Përcaktimi i peshave në përqindje të çdo tematikave, nëntematikave dhe temave që përmban testi në matricë dhe niveleve të arritjes:

Ndërtimi i tabelës së specifikimit

- Mësuesi duhet të përcaktojë numrin e kërkesave që duhet të përmbajë testi në përputhje me kohën e realizimit të tij.
- Koha e plotë duhet të jetë 45 minuta, pra 1 orë mësimore.
- Testi për tematikën “Qytetërimet botërore në Antikitë. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. Krishtit)” përmban 16 kërkesa.
- Duke patur parasysh nivelet e arritjeve të rezultateve të të nxënimit sipas kompetencave lëndore dhe peshat e përcaktuara sipas niveleve, ndërtojmë tabelën e BLUprintit.
- Për (Nivelin 2), testi përmban 8 kërkesa, pra 40% të kërkesave të përgjithshme të tij,

- për (Nivelin 3), testi përmban 8 kërkesa, pra 40% të kërkesave të përgjithshme të tij dhe
- për (Nivelin 4), testi përmban 4 kërkesa, pra 20% të kërkesave të përgjithshme të tij.
- Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe për tematikën “Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr.K. – shekullin V ps. K.)”.

Testi ka 32 pikë gjithsej

• **Tabela e specifikimeve të testit - Blueprinti**

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	N.2 40%	N. 3 40%	N. 4 20%
I.Qytetërimet në luginat lumore		50%	16	6	6	4
Lindja e qytetërimeve në luginat lumore.	Identifikon shkaqet që çuan në lindjen e qytetërimeve në luginat lumore dhe vlerëson rolin e mjedisit gjeografik në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit (Mesopotami, Egjipt)	10%	4	0	0	4
Qytetërimi në Mesopotami	përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore. Përkufizon termin “Kod”	3%	1	0	1	0
Qytetërimi egjiptian	Vlerëson rolin e lumit Nil në zhvillimin e qytetërimit egjiptian. Përcakton llojin e shkrimit që përdornin egjiptianët	5%	2	1	1	0
Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt	Identifikon arritjet në fushën e shkrimit dhe të ekonomisë së këtyre vendeve	15%	4	2	2	0
Ndarja dhe llogaritja e kohës në histori	Kryen veprime matematikore për të llogaritur kohën	10%	3	1	2	0
Parailirët dhe Ilirët	Identifikon vendet ku janë gjetur gjurmë parailire. Përkufizon konceptin “etnos ilir”.	7%	2	2	0	0
II.Qytetërimet në brigjet e Mesdheut		50%	16	6	6	4
Qytetërimet në brigjet e detit Mesdhe	Identifikon qytetërimet në brigjet e detit Mesdhe. Përcakton arritjet e fenikasve në fushën e shkrimit dhe ekonomisë	10%	3	2	1	0
Qytetërimi grek	Përkufizon konceptet demokraci, oligarki. Identifikon rolin dhe rëndësinë e demosit në Athinë.	12.5%	4	0	2	2

Qytetërimi romak	Përcakton vitin e themelimit të Romës. Përkufizon konceptin republikë. Identifikon rolin dhe rëndësinë e plebejëve në Romë.	12.5%	4	2	0	2
Ndërprerja e qyteterimit antik ne europe. fillimi i qyteterimit mesjetar	Dallon arsyet dhe pasojat e rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit. Përcakton kohën e rënies së saj dhe Perandorisë së Bizantit.	10%	4	1	3	0
Banorët e hershëm të Ballkanit dhe Ilirët	Dallon popujt e lashtë të Ballkanit	5%	1	1	0	0
Totali		100%	32	12	12	8

Modeli testi

Shembull 1. **Totali i pikëve: 32 pikë**

Emër mbiemër _____

Grupi: A

VLERËSIMI: PIKË _____ **NOTË** _____

1. Qytetërimi i parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore, ishte:

1 pikë

- A. Athinas
- B. Egjiptian
- C. Babilonas
- D. Romak

2. Kodi i Hamurabit ishte përpjekja e parë për qeverisje që bazohet në:

1 pikë

- A. ligj
- B. dhunë
- C. frikë
- D. besim

3. *Vepra letrare më e vjetër njihet:*

1 pikë

- A. Iliada
- B. Epi i Gilgameshit
- C. Odisea
- D. Tregime për përjetimin e fatkeqësive në det

4. Përkufizo termat e mëposhtëm:

4 pikë

Demokraci _____
 Oligarki _____
 Republikë _____
 Etnos ilir _____

5. Shëno një nga popujt më të hershëm të Ballkanit. 1 pikë

6. Lidh me shigjetë vitet me shekujt në të cilët bëjnë pjesë. 4 pikë

- | | |
|------------------|----------------|
| a. Viti 211 pr.k | Shek. XX |
| b. Viti 365 | Shek. III pr.k |
| c. Viti 1901 | Shek. X pr.k |
| d. Viti 910 pr.k | Shek. IV |

7. Plotëso tabelën duke shënuar një nga arritjet e qytetërimeve të mëposhtëme në fushën e shkrimit dhe të ekonomisë. 3 pikë

Qytetërimi	Arritjet
Në Mesopotami	
Në Egjipti	
Fenikas	

8. Pse luginat e lumenjve Nil, Eufrat, Tiger, Ind etj. u bënë djepi qytetërimeve të hershme? Argumento përgjigjen. 4 pikë

9. Shkruaj emrat e dy qyteteve të sotme në të cilat janë gjetur gjurmë të qytetërimit ilir. 1 pikë

a) _____ b) _____

10. Në fjalitë e mëposhtme vendos gërmën “V” për pohimet e vërteta dhe gërmën “G” për pohimet e gabuara. 3 pikë

- | | |
|--|-------|
| a) Fenikasit shtriheshin në territoret e Libanit të sotëm. | _____ |
| b) Roma u themelua në vitin 753 pr.k. | _____ |
| c) Egjiptianët përdornin shkrimin kuneiform | _____ |

11. Rendit tre nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit. 3 pikë

- a) _____
 b) _____
 c) _____

12. Krahaso rolin dhe rëndësinë e demosit në Athinë dhe plebejve në Romë. 4 pikë

13. Plotëso fjalinë e mëposhtme. 2 pikë

Perandria Romake e Perëndimit merr fund në shek _____, ndërsa Perandoria Romake e Lindjes do të vazhdojë të ekzistojë edhe për _____ vjet të tjerë.

Skema e vlerësimit të testit

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	6-10	11-15	16-20	21-24	25 –28	29 – 32

Pikët për secilën pyetje

Ush.	Pyetja	Pikë
1	Dallon qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore.	1 pikë
2	Përcakton Kodin e Hamurabit si përpjekja e parë për qeverisje që bazohet lig	1 pikë
3	Dallon veprën letrare më të hershëm të Ballkanit	1 pikë
4.1	Përkufizon konceptin Demokraci.	1 pikë
4.2	Përkufizon konceptin Oligarki.	1 pikë
4.3	Përkufizon konceptin Republikë.	1 pikë
4.4	Përkufizon konceptin etnos ilir.	1 pikë
5	Evidenton një nga popujt më të hershëm të Ballkanit.	1 pikë
6.1	Kryen veprime matematikore për të përcaktuar se cilit shekull i përket viti 211 pr.k	1 pikë
6.2	Kryen veprime matematikore për të përcaktuar se cilit shekull i përket viti 365 ps.k	1 pikë
6.3	Kryen veprime matematikore për të përcaktuar se cilit shekull i përket viti 1901 ps.k	1 pikë
6.4	Kryen veprime matematikore për të përcaktuar se cilit shekull i përket viti 910 pr.k	1 pikë
7.1	Përzgjedh një arritje në fushën e ekonomisë dhe shkrimit për qytetërimin në Mesopotami.	1 pikë
7.2	Përzgjedh një arritje në fushën e ekonomisë dhe shkrimit për qytetërimin Egjiptian.	1 pikë
7.3	Përzgjedh një arritje në fushën e ekonomisë dhe shkrimit për qytetërimin Fenikas.	1 pikë
8.	Argumenton arsyet e lindjes së qytetërimeve pranë luginave të lumit Tiger dhe Euftrat, Nil, Ind, Jance.	(1+1+1+1)
9.	Përcakton emërtimet e dy qyteteve të sotme në të cilat janë gjetur gjurmë të	1 pikë

	qytetërimet ilir.	
10.1	Vendos gërmën “V” për pohimin Fenikasit shtriheshin në territoret e Libanit të sotëm.	1 pikë
10.2	Vendos gërmën “V” për pohimin -Roma u themelua në vitin 753 pr.k.	1 pikë
10.3	Vendos gërmën “G” për pohimin -Egjiptianët përdornin shkrimin kuneiform.	1 pikë
11.	Rendit tre nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.	(1+1+1)
12.1	Përcakton rolin demosit në Athinë.	1 pikë
12.2	Tregon rëndësinë e demosit në Athinë.	1 pikë
12.3	Përcakton rolin plebejëve në Romë.	1 pikë
12.4	Tregon rëndësinë e plebejëve në Romë.	1 pikë
13.1	Përcakton kohën e rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit.	1 pikë
13.2	Përcakton jetëgjatësinë e jetesës së Perandorisë Romake e Lindjes.	1 pikë

Shembull 2. Testi periudha e parë; 45 minuta; Klasa VII

Totali i pikëve: 34 pikë

Tematika	Tema	Konceptet kyçe
Koha e ndryshimeve thelbësore	<ul style="list-style-type: none"> - Monarkia absolute dhe absolutizmi Francez; - Iluminizmi; - Anglia në përfundim dhe pas revolucionit; - Krijimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës; - Lufta Civile në SHBA; - Revolucion i Parë Industrial; - Revolucion Francez – shkaqet dhe shpërthimi i tij; Revolucion Francez. - Përmbysja e regjimit absolutist; - Napolon Bonaparti; - Epoka e restaurimit. Kongresi i Vjenës; - Epoka e Nacionalizmit dhe romantizmit 	<ul style="list-style-type: none"> - Absolutizëm; iluminizëm; - nacionalizëm, romantizëm, parlamentarizëm; - monarki parlamentare; liberalizëm; - zhvillim i vrullshëm; - luftë civile; - luftë për pavarësi; - kushtetutë, liri, barazi, vëllazëri; bashkim kombëtar; - shtet autonom, shtet i pavarur; revolucion industrial, nacertania, Greqia e madhe (megalidea);

Përcaktimi i rezultateve më kryesore të të nxëniet që do të testohen dhe grupimi i tyre sipas niveleve të arritjes:

Rezultatet kryesore të të nxëniet që do të testohen:	Grupimi i rezultateteve të nxëniet sipas niveleve të arritjes
<ul style="list-style-type: none"> - përkufizon ndonjë nga konceptet si: pushtet absolut, iluminizëm, nacionalizëm, romantizëm; - dallon figurat e shquara si Xhorxh Washington dhe Oto fon Bismark dhe kontributin e tyre; - tregon shkaqet e luftës civile në SHBA. - vlerëson figurën e Napolon Bonapartit; - përcakton ndryshimet që solli Kongresi i 	<p>Niveli 2 (nota 5-6)</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon ndonjë nga konceptet si: pushtet absolut, iluminizëm, nacionalizëm, romantizëm; - bën ndonjë nga lidhjet mes figurave Xhorxh Washington dhe Oto fon Bismark dhe kontributit të tyre; - përshkruan në mënyrë të thjeshtë figurën e Napoleon Bonapartit; - përcakton ndonjë nga vendimet e Kongresit të

<p>Vjenës në Hartën e Europës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - evidenton detyrat e lëvizjeve kombëtare në shek. XVIII-XIX; - përcakton fundin e feudalizmit në Francë dhe datën e festës kombëtare të saj; - evidenton shkaqet e revolucionit të vitit 1848 në Perandorinë Austriake; - krahason konceptet “shtet autonom” dhe “shtet i pavarur” dhe bën dallimet mes tyre; - krahason projektet “Nacertania” dhe “Greqia e madhe” dhe evidenton tiparet e përbashkëta; - analizon pasojat e revolucionit industrial dhe evidenton vlerat e tij; - vlerëson aktin mbi të Drejtat e Njeriut; - vlerëson rolin e shqiptarëve në revolucionin grek; 	<p>Vienës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - evidenton ndonjë nga detyrat e lëvizjeve kombëtare të shk.XVIII-XIX; - evidenton ndonjë nga shkaqet e revolucionit të vitit 1948 në Perandorinë Austriake; - evidenton ndonjë nga vlerat e revolucionit industrial; - përshkruan ndonjë nga ndryshimet që solli Akti mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze; - evidenton tiparin e përbashkëta projektet “Nacertania” dhe “Greqia e madhe”; - evidenton ndonjë nga rolet që luajtën shqiptarët në revolucionin grek. <p>Niveli 3 (nota 7-8)</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon disa nga konceptet si: pushtet absolute, iluminizëm, nacionalizëm, romantizëm; - bën lidhjet mes figurave Xhorxh Washington dhe Oto fon Bismark dhe kontributit të tyre; - përshkruan figurën e Napoleon Bonapartit; - përcakton disa ndryshimet që solli kongresi i Vjenës në Hartën e Europës; - evidenton detyrat e lëvizjeve kombëtare të shk.XVIII-XIX; - evidenton ndonjë nga shkaqet e revolucionit të vitit 1948 në Perandorinë Austriake; - evidenton ndonjë nga vlerat e revolucionit industrial; - përshkruan ndonjë nga ndryshimet që solli Akti mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze. - evidenton ndonjë nga rolet që luajtën shqiptarët në revolucionin grek. Krahason konceptet “shtet autonom” dhe “shtet i pavarur” dhe bën ndonjë nga dallimet mes tyre; - evidenton tiparin e përbashkët të projekteve “Nacertania” dhe “Greqia e madhe”; - vlerëson rolin që luajtën shqiptarët në revolucionin grek. <p>Niveli 4 (nota 9-10)</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon konceptet, pushtet absolute, iluminizëm, nacionalizëm, romantizëm; - dallon figurat e shquara si Xhorxh Washington dhe Oto fon Bismark dhe kontributin e tyre; - tregon shkaqet e luftës civile në SHBA. - përshkruan figurën e Napolon Bonapartit; - përcakton ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës në Hartën e Europës;
---	--

	<ul style="list-style-type: none"> - evidenton detyrat e lëvizjeve kombëtare në shek. XVIII-XIX; - përcakton fundin e feudalizmit në Francë dhe datën e festës kombëtare të saj; - evidenton shkaqet e revolucionit të vitit 1848 në Perandorinë Austriake; - krahason konceptet “shtet autonom” dhe “shtet i pavarur” dhe bën dallimet mes tyre; - krahason analizon pasojat e revolucionit industrial dhe evidenton vlerat e tij; - krahason të projekteve “Nacertania” dhe “Greqia e madhe” dhe videnton tiparin e përbashkët të tyre; - analizon pasojat e revolucionit industrial dhe evidenton vlerat e tij; - vlerëson aktin mbi të Drejtat e Njeriut; - vlerëson rolin e shqiptarëve në revolucionin grek;
--	---

Testi ka 34 pikë gjithsej

Tabela e specifikimeve të testit – Blueprinti

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	N.2 40%	N. 3 40%	N. 4 20%
I.Ndryshimet në kulturën politike dhe në ekonominë europiane		6	2	2	0	0
Monarkia absolute dhe absolutizmi Francez	Përshkruan konceptin pushtet absolut; përshkruan veçoritë e absolutizmit francez;	3	1	1	0	0
Iluminizmi	Përkufizon konceptin Iluminizëm. Evidenton ndikimin e tij.	3	1	1	0	0
II.Revolucioni Anglez, Amerikan dhe revolucioni i Parë industrial		21	7	5	2	0
Anglia në përfundim dhe pas revolucionit	Përcakton ndryshimet që sollli Aktin mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze	6	2	0	2	0
Krijimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës	Përcakton presidentin e parë të SHBA-së.	3	1	1	0	0

Lufta Civile në SHBA	Evidenton arsyet e Luftës Civile në SHBA.	3	1	1	0	0
Revolucioni i Parë Industrial	analizon pasojat e revolucionit industrial dhe evidenton vlerat e tij në ekonomi ;	9	3	3	0	0
III.Revolucioni Francez		27	9	2	4	3
Revolucioni Francez – shkaqet dhe shpërthimi i tij	Tregon shkaqet e revolucionit francez	6	2	1	1	0
Revolucioni Francez. Përmbysja e regjimit absolutist	Përcakton kohën e përmbysjes së regjimit absolutist. Analizon përmbysjen e absolutizmit dhe evidenton pasojat.	3	1	1	0	0
Napolon Bonaparti	Vlerëson figurën e Napoleon Bonapartit	9	3	0	3	0
Epoka e restaurimit. Kongresi i Vjenës	Dallon ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës në Hartën e Europës	9	3	0	0	3
IV.Jeta dhe nacionalizmi në Europën e shekullit XIX		46%	16	5	8	3
Epoka e Nacionalizmit dhe romantizmit	Përshkruan konceptin nacionalizëm; Tregon shkaqet e lindjes së nacionalizmit dhe përhapjen e tij në Evropë. Përcakton detyrat e lëvizjeve kombëtare.	11.3	4	2	2	0
Bashkimi gjermanisë	Vlerëson rolin e Oto Von Bismarkut. Përshkruan krijim e shtet-kombit në Gjermani	3	1	1	0	0
Perandoria Austriake në vitet 1840-1860	Evidenton shkaqet e Revolucionit të vitit 1848 në Perandorinë Austriake	9	3	0	3	0
Formimi dhe forcimi i shtetit modern grek	Vlerëson rolin e shqiptarëve në revolucionin grek. Përshkruan projektin “Greqia e madhe”.	11.3	4	1	3	0
Formimi dhe forcimi i shtetit serb	Bën dallimin mes shtetit të pavarur dhe atij autonom. Përshkruan projektin “Naçetania” Krahason projektin “Naçetania” me “Greqia e madhe” dhe evidenton tiparin e	11.3	4	1	0	3

	përbashkët.					
Totali		100%	34	14	14	6

Modeli testi 2.

Totali i pikëve: 34 pikë

Emër mbiemër _____

Grupi: B

Vlerësimi: PIKË _____ **NOTË** _____

1. **Qarko alternativën e saktë. Më 11 gusht 1789 Asambleja Kushtetuese në Francë shpalli me ligj:** 1 pikë
 - A. Vendosjen e feudalizmit
 - B. Vendosjen e kapitalizmit
 - C. Heqjen e feudalizmit
 - D. Heqjen e kapitalizmit

2. **Qarko alternativën e saktë. Luftës Civile në SHBA u zhvilluan në vitet:** 1 pikë
 - A. 1861-1864
 - B. 1861-1865
 - C. 1862-1866
 - D. 1862-1865

3. **Plotëso fjalitë e mëposhtme:** 4 pikë
 - a) Në monarkinë absolute sundon _____.
 - b) Festa kombëtare e Francës është data _____.
 - c) Presidenti i parë i ShBA-ve është _____.
 - d) _____ u quajt arkitekt i bashkimit të Gjermanisë.


4. **Dy detyrat që do të zgjidhnin lëvizjet kombëtare në shek. XVIII-XIX janë:** 2 pikë
 - a) _____
 - b) _____

5. **Përkufizo konceptet e mëposhtme.** 3 pikë
 - a) Nacionalizëm _____
 - b) Romantizëm _____
 - c) Iluminizëm _____

6. **Përcakto dallimet mes koncepteve “Shtet i pavarur” dhe “Shtet autonom”.** 3 pikë

7. Plotëso skemën duke vendosur një vlerë për çdo degë të ekonomisë.

3 pikë



8. Shkruaj dy nga ndryshimet që solli Akti mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze.


2 pikë

a) _____

b) _____

9. Plotëso skemën duke vendosur tiparin e përbashkët të programeve/projekteve “Naçertania” dhe “Greqia e Madhe”

2 pikë



10. Përshkruaj me tre fjali figurën e Napoleon Bonapartit

3 pikë

11. Shkruaj tre nga ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës në Hartën e Europës **3 pikë**

- a) _____
b) _____
c) _____

12. Cilat ishin shkaqet e Revolucionit të vitit 1848 në Perandorinë Austriake? **3 pikë**

- a) _____

- b) _____

- c) _____

13. Përshkruaj rolin e shqiptarëve në Revolucionin Grek? **3 pikë**

Skema e vlerësimit të testit:

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	6-11	12-16	17-21	22-26	27 – 30	31 – 34

9. BIBIOLIOGRAFIA

- IZHA, 2014, KORNIZA KURRIKULARE.
- IZHA, 2014, KURRIKULA BËRTHAMË AMU, KLASAT 6-9.
- IZHA, 2014-2018, PROGRAMET ME KURRIKULËN E BAZUAR NË KOMPETENCA, KLASAT 6 – 7 – 8 – 9.
- TEKSTET E HISTORISË PËR KLASAT 6 – 7 – 8 – 9.
- IZHA, 2015, KORNIZA E VLERËSIMIT TË NXËNËSIT.
- IZHA, 2016, NIVELET E ARRITJES (ARSIMI BAZË).
- IZHA, 2017, UDHËZUESI I ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT.